

THESARE

MJET FRYMËZIMI DHE UDHËRRËFYES PËR PASTORËT DHE SHËRBYESIT

numri 5 / verë 2015

Editorial <i>Gëzim Spahija</i>	2
Ta Themi të Vërtetën me Dashuri: Përse Ungjillizimi nuk është Jotolerant <i>Joseph Dimitrov</i>	3
Çmimi i Lartë i të Qenit i Humbur (Dhe çfarë mund të bëjmë rreth kësaj) <i>Alan R. Johnson</i>	10
Rrjeta e Mbretërisë <i>Joseph L. Castleberry</i>	16
Të Mbajmë Bashkë Dhembshurinë dhe Ungjillizimin <i>Jerry Ireland</i>	21
Ndikim Përmes Komunikimit <i>Marcia Lednicky</i>	28
Kishëmbjellja në Bathore <i>Miljard Gosturani</i>	34

Tema e këtij numri: Ungjillizimi - Puna jonë më e madhe



Ungjillizimi: Puna jonë më e madhe

Një nga detyrat më të rëndësishme të Kishës është ajo e ungjillizimit të botës. Vetë koncepti i botës është një term shumë i gjerë, por e specifikuar do të thotë, në pjesën në të cilën Perëndia na ka thirrur. Nuk e di nëse ia ke bërë ndonjëherë pyetjen vetes, pse Perëndia më ka shpëtuar mua? Pse pikërisht në këtë vend? Pse pikërisht në këtë kishë? Që të arrijmë te korja, na duhet patjetër që të mbjellim. Dhe të mbjellësh është një punë e vështirë, por shumë e bukur. Siç thuhet në Shkrim, ata që mbjellin me lot, do të korrin me gëzim. Ti je këtu për të plotësuar nevojat e njerëzve, sepse Zoti të ka zgjedhur si administrator të hirit shumëfarësh të Perëndisë. Nëse nuk mbjell edhe nuk do të korrësh, dhe nuk do të kesh çfarë të hash. Prodhimi është inkurajimi ynë.

Le ta falenderojmë Zotin për tokën që na ka besuar e na e ka dhënë në zotërim. Le të lutemi që ai të na e tregojë planin e tij. Fjala e Zotit është fara e mirë për t'u mbjellë. Ajo na garanton siguri se do të japë fryt. E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak. Lutjuni, pra, Zotit të të korrave që të dërgojë punëtorë në të korrat e tij. Mos u gënjeni--Perëndia nuk vihet dot në lojë, sepse ç'të mbjellë njeriu, atë edhe do të korrë. Ai që

mbjell për mish të tij, do të korrë nga mishi i tij prishje, por ai që mbjell për Frymë, do të korrë nga Fryma jetë të përjetshme.

“Le të mos lodhemi duke bërë të mirën; sepse, po të mos lodhemi, do të korrim në kohën e vet. Por ai që do të ngulmojë deri në fund do të shpëtohet. Dhe ky ungjill i mbretërisë do të predikohet në gjithë botën si një dëshmi për gjithë kombet, dhe atëherë do të vijë mbarimi. Sepse kujtdo që do t'i vijë turp për mua dhe fjalët e mia në mes të këtij brezi kurorëshkelës dhe mëkatar, për atë do t'i vijë turp edhe Birit të njeriut, kur të vijë në lavdinë e Atit të vet, me engjëjt e tij të shenjtë.”

Nëse ti je sot këtu ku je, kjo ka ndodhur për shkak se dikush ka mbjellë në ty dje, që ti të ishe fryt. Mendo këtë: në mënyrë që nesër të kesh fryt, duhet të ungjillizosh sa më shumë dhe të mbjellësh sot.



GËZIM SPAHIJA

Drejtor Ekzekutiv i Këshillit të
Përgjithshëm të Asambleve të
Perëndisë të Shqipërisë

THESARE

Numri 5
Verë 2015

Koordinatorë e projektit: Stephanie Plagenhoef
Përkthyes: Fabian Tozharaku
Redaktues: Skënder Hoxha
Grafika kompjuterike: Lindita Sqapi

Botuar nga:
Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë
të Shqipërisë

Në bashkëpunim me:
Life Publishers International

Adresa: K.P. 119 / Kutia 2 / Tirana, Albania
Cel: 0694068956
Email: KTU@icc-al.org



Artikujt e zgjedhur dhe grafika përshtatur nga revista Enrichment - ©Këshilli i Përgjithshëm i Asambleve të Perëndisë, ShBA. Përdorur me leje.

©Life Publishers International. Të gjitha të drejtat të rezervuara.

Ta Themi të Vërtetën me Dashuri:

PËRSE UNGJILLIZIMI NUK ËSHTË

JOTOLERANT

Nga: JOSEPH DIMITROV

NE KEMI
TË
DREJTAT
TONA

JEZUSI
ËSHTË
PËRRALLË

MBAJENI
PER VETE
BESIMIN
TUAJ

FANATIKË

URREJTJA
NUK ËSHTË
VLERË
FAMILJARE

Si mund ta vazhdojë
më tej Kisha
mandatin e saj të
dhënë prej
Perëndisë në një
atmosferë, e cila në
pikën më të mirë të
saj, është e
mbushur me
mospërfillje
frymërore, dhe në
atë më të keqen, me
kundërshtim
militant? Në këtë
ambient të tillë
cinik, në ç'mënyrë
do të mundën të
krishterët që ta
shpallin me
efikasitet ungjillin?
Dhe si ndryshojnë
perceptimet tona
rreth ungjillizimit
nga ata që janë
jashtë besimit?

Pra, unë do të digjem në ferr për shkak se nuk besoj?”

Ky ishte reagimi kundërvënës e i mbushur plot sarkazëm i një, burri gjatë orës së mësimi të gjuhës holandeze ku po merrte pjesë vajza ime, në momentin që ajo tregoi se, si e krishterë, besonte në jetën pas vdekjes. Kjo bisedë u hap si pjesë e një diskutimi akademik rreth natyrës frymërore. Megjithatë vajza ime e shpjegoi se nuk kishte për qëllim të gjykonte askënd, klasa shpërtheu në një debat që vinte në dyshim madje edhe të drejtën e saj për të folur rreth besimit të saj.

Çfarë nuk shkon me këtë tablo? Nëse vajza ime do të kishte pohuar se ishte myslimane ose budiste, besoj se do të kishte marrë një reagim më pozitiv. Përse ndihen njerëzit kaq të paretshëm me mesazhin e ungjillit? Në një shoqëri që inkurajon larminë dhe shkëmbimin e lirë të ideve, përse shumë njerëz i sulmojnë të krishterët – madje, shpeshherë ende pa i dëgjuar se çfarë kanë për të thënë? Në shumë aspekte, krishterimi ka mbërritur në një pikë përplasjeje me kulturën tonë post-moderne.

SI ERDHËM NË KËTË PIKË?

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, duhet të marrim parasysh ndryshimet e vullshme të 300 viteve të fundit, duke filluar me epokën e Iluminizmit, në shekullin e 18-të. Kjo periudhë, e cila lartësonte arsyen njerëzore si nivelin më të lartë të autoritetit, kërkonte që ta zëvendësonte ndikimin hyjnor me kërkimet intelektuale. Përgjatë kohës që zbulimet mbresëlënëse të shkencës mbërthyen imagjinatat akademike në mënyra, të cilat, eventualisht, zbritën deri tek publiku i përgjithshëm, gjithmonë e më shumë njerëz filluan ta vinin në dyshim nevojën për krishterimin.

Epoka moderne e marginalizoi (e la mënjanë) edhe më tej rolin e besimit në shoqëri deri në pikën ku bota laike nuk e shikonte ungjillizimin vetëm me skepticizëm, por me armiqësi.¹ Shumë njerëz i refuzuan si jotolerante pohimet e krishterimit rreth të vërtetës hyjnore, absolutësisë morale dhe shpëtimit vetëm përmes Krishtit. Njerëzit filluan të ofendohen nga mësimet biblike të cilat nuk lënë hapësira për realitete alternative ose për paradigma (modele) kontradiktore.

Për më tepër, ndryshimet e shpejta në teknologjinë e informacionit dhe lëvizshmëria më e madhe e popullsisë dhe ideve i hapën rrugën interesimit rreth një sërë fesh të Lindjes dhe adoptimit të humanizmit laik. Ky zhvillim sfidoi vlerat judeo-kristiane mbi të cilat u themelua një pjesë e madhe e shoqërisë perëndimore. Të drejtat individuale dhe pranimi reciprok u kthyen në parimet kryesore të shoqërisë.

Kultura e sotme tregon një pakënaqësi në rritje edhe me konceptin e tolerancës, duke e parë atë me cinizëm si një mjet që idetë e papranueshme të fitojnë ndikim. Sipas kësaj tendence të re postmoderne, toleranca është më pak e rëndësishme sesa të zbërthesh sisteme absolute ose relative të besimit, të cilat mund t’i bëjnë të tjerët të mos ndihen rehat.²

E gjithë kjo duhet të na drejtojë tek disa pyetje të shëndetshme. Si mund ta vazhdojë më tej Kisha mandatin e saj të dhënë prej Perëndisë në një atmosferë, e cila në pikën më të mirë të saj, është e mbushur me mospërfillje frymërore, dhe në atë më të keqen, me kundërshtim militant? Në këtë ambient të tillë cinik, në ç’mënyrë do të mundën të krishterët që ta shpallin me efikasitet ungjillin? Dhe si ndryshojnë perceptimet tona rreth ungjillizimit nga ata që janë jashtë besimit?

BAZAT E UNGJILLIZIMIT TË KRISHTERË

Le të përkufizojmë ungjillizimin e vërtetë, përpara se t’iu përgjigjem këtyre pyetjeve të rëndësishme. Ekzistojnë dy përbërës kryesorë rreth ungjillizimit biblik: ai përmban një mesazh dhe shfaq një qëndrim. Njëri nuk mund të funksionojë pa tjetrin. Ungjillizimi që komunikon një mesazh, por i mungon qëndrimi i duhur nuk është veçse një mjet propagandistik. Ungjillizimi duhet të ilustruhet me shembuj, dhe jo thjesht të thuhet me të bërtitura. Nga ana tjetër, ungjillizimi që tregon dhembshuri ose dashamirësi pa shpallur mesazhin e ungjillit, është si një tabelë me shenja që nuk të drejton askund.

Ja pse Gjoni 3:16 është kaq i fuqishëm dhe kuptimplotë. Sepse komunikon mesazhin e shpëtimit ndërkohë që, në të njëjtën kohë, zbulon ndjenjën pas këtij mesazhi: “Perëndia e deshi atë që botën ... “. Dashuria e Perëndisë vuri në lëvizje planin e Tij të shpëtimit, dhe deklarimi i këtij lajmi të mirë zbulon zemrën e Tij për njerëzimin. Ungjillizimi efikas ngrihet nga dashuria dhe shpallet me dashuri.

**Një individ,
pasi ta ketë dëgjuar mesazhin e
thjeshtë të shpëtimit përmes Krishtit,
duhet të zgjedhë ta shpërfillë, ta pranojë
ose ta kundërshtojë atë. Këtu nuk ka
asgjë jotolerante, sepse të drejtat dhe
vullneti i lirë i çdo anëtarit të shoqërisë
sonë pluraliste po
respektohen.**

Mesazhi i ungjillit pa qëndrimin e dashurisë dhe dhembshurisë së Perëndisë është i zbrazët. Pikërisht kjo dashuri e Perëndisë na detyron të shkojmë drejt shpalljes. Nuk duhet ta harrojmë kurrë se Fryma e Shenjtë përdor edhe mesazhin e ungjillit, edhe qëndrimin me dashuri të ungjillit.

Ungjilli përmban një mesazh të pakompromentueshëm. Jezusi deklaroi: “Askush nuk vjen tek Ati përveçse nëpërmjet meje”, dhe shpalli se Ai është “udha, e vërteta dhe jeta” (Gjoni 14:6).

Shumë vargje të tjera e mbështesin këtë të vërtetë. Autorët e Ungjijve nuk paraqitën një mesazh neutral duke e lënë të lirë sipas secilit prej lexuesve interpretimin e fjalëve të tyre. Ata shkruan me anshmëri dhe me një mision ungjillizues: “Por këto gjëra janë shkruar që ju të besoni se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë dhe që, duke besuar, ta keni jetën në emër të tij” (Gjoni 20:31).

Nuk ka asnjë paqartësi për sa i përket rrugës së shpëtimit. Pikërisht ky mesazh i qartë i shqetësonte hebrenjtë dhe grekët e kohës së Palit. Pali e dinte se bashkëkohësit e tij nuk mund ta përshtatnin mesazhin e Kryqit që të përputhej me pritshmëritë e tyre. Përgjatë shekujve, Fjala nuk ndryshon kurrë. Përkundrazi, na thërret neve që të ndryshojmë dhe të bëhemi si Jezusi. Shumë kohë para epokës sonë të postmodernizmit, Pali reflektoi mbi tolerancën dhe si lidhet ajo me ungjillin, por doli në përfundimin e patundur: “Sepse, po të kërkoja t’u pëlqej njerëzve, nuk do të isha shërbëtor i Krishtit” (Galatasve 1:10).

Pali, si përgjigje ndaj mësuesve të rremë, të cilët u përpoqën ta afronin ungjillin më shumë me Judaizmin dhe ta bënin të dukej më i pranueshëm, insistoi se çdo përpjekje për të ndryshuar mesazhin do ta bënte atë të kthehej në “një ungjill tjetër, i cili nuk është tjetër” (Galatasve 1:6, 7).

Ndërkohë që mesazhi është i qartë, qëndrimi i ungjillit me dashuri është gjithëpërfshirës. Perëndia i do të gjithë dhe do që të gjithë njerëzit të marrin shpëtimin që vjen përmes Krishtit (1 Timoteut 2:3-5). Bibla i urdhëron të krishterët që t’i duan të tjerët, t’ia predikojnë lajmin e mirë të gjithë krijimit dhe të jetojnë në paqe me të gjithë (Marku 12:31; 16:15; Hebrenjve 12:14). Jezusi i deshi dhe priti si miq të gjithë llojet e njerëzve, që nga lebrozët dhe tagrambledhësit, e deri tek mëkatarët dhe lypsarët. Edhe pse drejtuesit fetarë e kritikuan atë se po shoqërohej me njerëz që kishin nam të keq, ata që ishin të dëbuar nga shoqëria gjetën një mik të vërtetë tek Jezusi. Ai vazhdon të presë me gëzim cilindo që vjen tek Ai.

Romakëve 10:13 shpall: “Kushdo që do ta thërrasë emrin e Zotit do të shpëtohet”. Ungjilli nuk është përjashtues. Perëndinë nuk e shqetëson etnia e dikujt, statuti shoqëror apo pamja fizike, sfondi fetar apo ndonjë karakteristikë tjetër sipërfaqësore. Ai i fton të gjithë që të vijnë dhe të marrin falas dhuratën e Tij të shpëtimit. Ai na urdhëron

të predikojmë mesazhin e tij për këdo që është i gatshëm ta dëgjojë atë.

Madje edhe kur njerëzit e refuzojnë ungjillin, ne duhet t’i duam. Kur na përndjekin për shkak të mesazhit, duhet t’i falim dhe të vazhdojmë me dashuri. T’i duam të tjerët është ungjillizim me veprim, dhe shpeshherë kjo është e vetmja gjë që mund të bëjmë. Ndërkohë që fetë e tjera shprehin pranim vetëm kur mesazhi i tyre pranohet, besimi i krishterë nuk vendos kufij mbi dhembshurinë. Dashuria e Jezusit nuk reshti në kryq. Shqetësimi i Stefanit për të tjerët nuk përfundoi kur u përball me vdekjen me gurë. Martirët e hershëm të krishterë, duke u djegur si pishtarë në turrën e druve apo duke u shqyer nga kafshët për shkak të besimit të tyre, nuk reshtën së pasuri dashuri dhe falje për xhelatët e tyre. Ata ishin dëshmitarë të refuzimit të mesazhit, por, që të gjithë, treguan qëndrimin e duhur të ungjillit – vetinë e dashurisë.

Bibla e vë në zbatim këtë parim edhe për njësinë më të vogël të shoqërisë, që është familja. Për personat e krishterë që kanë një bashkëshort/e jobesimtar/e, që ende nuk e kanë pranuar mesazhin, Pali i pyet: “Sepse çfarë di ti, o grua, nëse ke për ta shpëtuar burrin? Ose ç’di ti, o burrë, nëse ke për ta shpëtuar gruan?” (1 Korintasve 7:16).

Po ashtu, edhe Pjetri tha që gratë duhet të mbajnë një qëndrim të perëndishëm dhe të dashur kundrejt bashkëshortëve të tyre “që, edhe nëse disa nuk i binden fjalës, të fitohen pa fjalë, nga sjellja e grave të tyre” (1 Pjetrit 3:1).

UNGJILLIZIMI DHE TOLERANCA

Na duhet ta themi se tensioni midis ungjillizimit dhe tolerancës është deri diku i natyrshëm për shkak se, edhe pse të dyja kanë pika të përbashkëta, qëllimi përfundimtar i tyre është i ndryshëm. Qëllimi i lëvizjes së tolerancës është paqja dhe pranimi reciprok midis segmenteve të ndryshme të shoqërisë. Qëllimi i ungjillizimit është paqe e vërtetë në zemrën e individit përmes paqimit me Perëndinë.

Kultura jonë perëndimore e vë në dyshim nocionin e të vërtetës absolute. Sipas mendimit të shkencave

humane, e vërteta përparon me kalimin e kohës ndërkohë që shoqëritë dhe besimet ndryshojnë. Për të shmangur një gjuhë që mund të ofendojë dikë, bota na kërkon të pranojmë sot atë që deri dje konsiderohej plotësisht e gabuar.

Pavarësisht nga kjo shtytje e furishme për tolerancë, politikat e gjuhës që nuk ofendon askënd (ose, të gjuhëve politikisht korrekte) nuk kanë ofruar ende asnjë zgjidhje reale ndaj problemeve të botës. Toleranca synon të përmirësojë shoqërinë tonë të larmishme duke u mësuar njerëzve që të lenë mënjane bindjet personale dhe konceptet e të vërtetës për të përqaftuar ndryshimet. Megjithatë, çështja e shërimit të brendshëm dhe e transformimit mbetet në njëfarë mënyre pa marrë asnjë përgjigje. Të gjitha qeniet njerëzore kanë të përbashkët të njëjtën natyrë mëkatore, përjetojnë të njëjtat ndjenja dhe mendojnë rreth të njëjtave pyetje ekzistencialiste. Shpirtrat tanë të përjetshëm digjen për të vërtetën dhe përmbushjen të cilën e ofron vetëm Jezusi.

Krishti na thërret ta çojmë Fjalën e tij të pandryshueshme në një botë të ndryshueshme. Nuk e ndryshojmë mesazhin, por mund të përshtatim metodat tona. Ndoshta përqasja që është më e ngjashme me kulturën e sotme është bindja (ose përpjekja për të bindur). Jetojmë në një botë me shprehje të shumta intelektuale. Arti, letërsia, filozofia, argëtimi, reklamimi dhe teknologjia konkurrojnë për të marrë vëmendje.

Komunikimi për të bindur mirëpret diskutime të bazuara mbi një shkëmbim idesh me respekt për njëri-tjetrin. Në këtë kontekst të njohur, nga pikëpamja kulturore, mund të dalë një bashkëbisedim i singertë. Imagjinoni që dy zyrtarë të zgjedhur, me pikëpamje politike të ndryshme, të takohen bashkë për kafe. Përmes situatave ku të dy mund të japin dhe të marrin, ata bien dakord për të mos qenë dakord me njëri-tjetrin, gjejnë pika të përbashkëta, ofrojnë ide për t'u marrë në konsideratë dhe përfundimisht ndërtojnë një marrëdhënie pavarësisht nga ndryshimet e tyre.

Apostulli Pal, gjatë udhëtimeve të tij misionare, praktikoi përpjekjen për të bindur nëpër sinagoga, në tregje dhe në vendtakime të tjera publike. Duke u përballur me filozofët në Athinë (Veprat e Apostujve 17:16-34), ai përdori me respekt besimet dhe shkrimet e tyre për të prezantuar ungjillin. Kjo metodë civile e bindjes nuk u kthye në një bashkëbisedim pa fund e pa krye. Zakonisht ajo vinte në pikën ku audiencës i ofrohej mundësia për të bërë një zgjedhje pa ndonjë shtrëngim.

Pali shprehu respekt dhe i tërhoqi dëgjuesit e tij që ta respektonin dhe ta merrnin në konsideratë motivin e singertë që fshihej pas mesazhit të tij. "Ne, pra,

bëhemi lajmëtarë për Krishtin, sikurse Perëndia të këshillonte nëpërmjet nesh; dhe ne ju këshillojmë juve për hir të Krishtit: Paqtohuni me Perëndinë!" (2 Korintasve 5:20).

Manipulimi dhe intimidimi nuk kanë vend në shpalljen e ungjillit. Këto përqasje transmetojnë një frymë superioriteti, dhe përdorimet e tyre kanë shënuar njollat e errëta në historinë e Kishës. Ungjillizimi i vërtetë nuk është një mjet për të arritur një pozicion mbizotërues mbi segmente të tjera të shoqërisë. Fjala e Perëndisë është e gjallë dhe aktive; ajo nuk konkurron me metodat propagandistike të feve të tjera.

Të rrethuar nga agnostikët, ateistët, mendimtarët liberalë dhe njerëzit e besimeve të tjera, detyra jonë nuk është që të tërhiqemi nga ata për shkak se janë të ndryshëm nga ne, por të angazhohemi në një komunikim kuptimplotë, i cili zbulon mesazhin unik të ungjillit për shpresën dhe qëndrimin me dashuri që kemi për çdo person. Ne kemi atë për të cilën bota ka kaq shumë nevojë. Dhe prandaj, e ofrojmë atë nga një zemër që kërkon t'i shërbejë të tjerëve dhe të nderojë Perëndinë. Kjo është përqasja që Pali përshkruan tek 2 e Korintasve 5:11: "Duke e njohur frikën e Zotit, ne bindim njerëzit..."

Mesazhi i vërtetë i ungjillit bën thirrje për një reagim, për një përgjigje. Kjo çon shumë vetë në presupozimin e rremë se ungjillizimi është jotolerant. Në fund të fundit, Jezusi kërkon të ndryshojë zemrat, ndërkohë që bota i inkurajon njerëzit të qëndrojnë në mëkat dhe të përqafojnë jetesën egocentrike në emër të diversitetit. Një individ, pasi ta ketë dëgjuar mesazhin e thjeshtë të shpëtimit përmes Krishtit, duhet të zgjedhë ta shpërfillë, ta pranojë ose ta kundërshtojë atë. Këtu nuk ka asgjë jotolerante, sepse të drejtat dhe vullneti i lirë i çdo anëtarit të shoqërisë sonë pluraliste po respektohen.

Kur e komunikojmë ungjillin në mënyrë autentike, ai nuk tingëllon shumë tërheqës. Filozofitë bashkëkohore promovojnë ndjekjen e fitimit personal, të udhëhequr nga vlera dhe të vërteta relative, dhe nuk e rëndon individin me kokëçarje të tepërta për t'u marrë me ndërgjegjen ose me parimet morale. Krahasoni këtë me vetëmohimin, të jetuarit me drejtësi dhe llogaridhënien ndaj Fjalës dhe Frymës së Perëndisë. Mesazhi i ungjillit shpall shpëtimin nga mëkati dhe dhuratën e jetës së përjetshme, por gjithashtu na bën thirrje që ne të marrim përgjegjësi personale. Duhet të jemi të gatshëm të mohojmë natyrën e vjetër mëkatore, të kthehemi nga keqbërja dhe t'i dorëzojmë plotësisht jetët tona Krishtit – duke vendosur planet e Tij përpara planeve tona. Kjo është një shkëputje radikale nga mënyra se si i bën bota gjërat. A nuk është kjo arsyeja pse shumë nga dishepujt e Jezusit e lanë atë? Prandaj, prezantimi biblik i ungjillit nuk ka asgjë të përbashkët me



teknikat e konvertimit që i manipulojnë njerëzit përmes tezgave tërheqëse të shitjes. Për këtë arsye, metoda e bindjes racionale (duke përdorur arsye-timin) ofron mundësinë më të mirë për një shpjegim të plotë dhe objektiv të mesazhit.

Përpjekjet për t'ia mbyllur gojën ungjillit për hir të tolerancës nxjerrin në shesh hipokrizinë që fshihet pas ithtarëve arrogantë të "diversitetit". Kur një shoqëri pluraliste përdor taktika të tilla, ajo kthehet në një shoqëri autoritare, ku elita përcakton se si duhet të mendojë, të flasë dhe të veprojë pjesa tjetër e shoqërisë.

Kohët e fundit, një grup studentësh të krishterë në qytetin tonë bëri një kërkesë për të organizuar një grup të krishterë studentor. Kushtetuta e universitetit të tyre prestigjioz i lejon dhe i inkurajon formimet e grupeve civile të ndryshme studentore. Mes të tjerëve, aty ekziston një organizëm hebraik, si dhe

një grup arabo-europian. Pse të mos ekzistonte edhe një grup i krishterë? E megjithatë, këshilli i universitetit e refuzoi kërkesën, duke pretenduar se etiket, besimet dhe doktrinat e krishtera nuk përputhen me parimet e mendësisë pluraliste dhe të tolerancës sociale. Këshilli iu rekomandoi studentëve që ta rishikonin propozimin e tyre për t'i hequr referencat rreth krishterimit. Konkluzioni i thjeshtë ishte që grupi studentor i krishterë që u propozua mund të ishte çdo gjë tjetër përveçse i krishterë.

Pavarësisht nga sa zhgënjyes mund të jetë një diskriminim i tillë zhurmëmadh, frika e refuzimit nuk duhet ta çojë Kishën nën tokë (si një organizatë e fshehur). Perëndia nuk do që ne të jemi të izoluar nga shoqëria. Kur Jezusi u lut për kishën, Ai tha: "Unë nuk kërkoj që ti t'i heqësh nga bota ... sikurse ti më ke dërguar mua në botë, po ashtu unë i kam dërguar ata në botë" (Gjoni 17:15,18).

ROLI I UNGJILLTARIT SHËTITËS



Nga: **SCOTT CAMP**

Një ungjiltar ka një pasion për të arritur të humburit. Ekziston një ndryshim midis një personi që ka një dhunti "për të prashitur besimtarët", në mënyrë që ata të kërkojnë Perëndinë në rizgjim, dhe atij personi që ka dhunti për të korrur të humburit.

Ndryshimi parësor është fokusi i predikimit. Predikimi i ungjilltarit përqendrohet tek ajo që ka bërë Perëndia përmes Krishtit për t'i paqtuar të humburit me Të. Ungjiltari ka dhuntinë për t'iu folur njerëzve që janë të humbur. Ai ose ajo identifikohet me jobesimtarët. Shpeshherë një ungjiltar ka një histori personale dramatike për mënyrën se si është konvertuar. Kjo mund të ndërtojë ura me të rinjtë.

Megjithatë, mesazhi shtrihet përtej çfarëdo dëshmie personale. Fokusi është ungjilli – jeta, vdekja, ringjallja, ngjitja dhe mbretërimi i Krishtit. Ungjiltari iu bën thirrje dëgjuesve që të pendohen dhe të kthehen në besim tek Krishti. Ai ose ajo është jashtëzakonisht i/e talentuar për të ofruar një ftesë publike.

FTONI NJË UNGJILLTAR EFEKTIV

Një ungjiltar efektiv, bashkë me pasionin për të arritur të humburit duke i thirrur njerëzit që të pendohen nga mëkatet dhe t'i besojnë Jezusit, ka edhe një plan për ta mbushur ndërtesën me

njerëz që kanë nevojë për Jezusin. Asgjë nuk e acaron më shumë ungjilltarin sesa një dështim për të tërhequr grupe të mëdha njerëzish (që nuk shkojnë në mënyrë të rregullt në kishë), për të ardhur në takimin ungjillizues.

Ndërtesa mund të jetë plot e përplot, por nëse është e tejmbushur vetëm me të krishterë, shërbesa e fushatës do të dështojë. Çdo ungjiltar për të korrur ka një strategji për të arritur të humburit. Një plan i tillë i dhënë nga Perëndia përqendrohet tek arritja e grupeve të ndryshme që janë brenda një komuniteti. Ngjarjet e veçanta para shërbesës tërheqin burra, gra, fëmijë dhe studentë.

Për shembull, kisha mund të servirë një vakt ushqimi dhe të ftojë folës të veçantë për të ndarë dëshmi që janë me interes për të humburit. Shumë ungjiltarë të korrash arrijnë të fitojnë mundësinë për të hyrë në shkollat publike përmes programeve kuvendore. Skuadrat atletike, bandat marshuese të shkollave të mesme dhe grupe të tjera jashtëshkollore marrin ftesa për të ardhur në fushatë.

Pastori i inkurajon anëtarët e kishës që të sjellin anëtarët jobesimtarë të familjes, kolegët e punës, fqinjët dhe shokët e tyre në ngjarjet para shërbesës. Të ftuarit dhe anëtarët e kishës marrin çmime për numrin më të madh të shokëve/shoqeve që kanë sjellë.

Me pak fjalë, takimi ka një atmosferë emocionuese, tërheqëse dhe festive. Muzika duhet të fokusohet tek Jezusi, Kryqi, Gjaku dhe Ardhja e Dytë.

Me lutje dhe përgatitje, mori të mëdha njerëzish mund të reagojnë ndaj ftesës për të ardhur tek Jezusi. Kjo gjithashtu ndez rizgjimin në mesin e popullit të Perëndisë. Në çdo shërbesë duhet të

ndodhë pagëzimi në ujë dhe Frymë i të konvertuarve të rinj.

NDIQNI UDHËHEQJEN E UNGJILLTARIT

Pastorë, lejojeni ungjilltarin që ta drejtojë takimin – dhe jo thjesht që të predikojë. Ndiqni planin dhe çdo detaj të tij. Ndiqmoni në organizmin e njerëzve tuaj. Dështimi në planifikim do të thotë planifikim për dështim. Çdo anëtar i bashkësisë duhet të ketë një përgjegjësi gjatë fushatës.

Mbani mend, ungjiltari është një specialist që Perëndia e thërret për këtë punë. Lejojeni specialistin që të drejtojë fushatën. Shumë ungjiltarë sjellin një skuadër që mund të ketë në përbërje një drejtues adhurimi, njerëz që punojnë me fëmijët dhe të rinjtë, dhe të ftuar të tjerë të podiumit.

RRETH FINANCAVE

Bashkësia duhet të paguajë shpenzimet për fushatën. Ua shpjegoni njerëzve tuaj aspektet unike të një shërbese shëtitëse. Pyeteni ungjilltarin rreth kriterëve të buxhetit, dhe lutuni e punoni për ta tejkualuar këtë nevojë. Vendosi një qëllim për ofrimin. Besojini Perëndisë dhe informojini njerëzit rreth qëllimit.

Ungjillizimi me fushata nuk është mënyra e vetme për të arritur të humburit. Por, përgjatë viteve, ka treguar se është efikase, dhe kishat që përdorin ungjiltarë fitojnë më shumë shpirta sesa ato që nuk i përdorin ata

SCOTT CAMP, i ftuar i emisioneve të posaçme me organizatën "Fushatat e Billi Graham" (Billy Graham Crusades), predikon kudo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe në Afrikën Perëndimore.

Armiku ynë nuk është kultura ku jetojmë. Përkundrazi, ne luftojmë me forca demonike që nuk shihen të cilat kërkojnë t'i pengojnë njerëzit që të mos arrijnë në njohurinë shpëtuese të Krishtit (Efesianëve 6:12). Si mëkatarë të shpëtuar me anë të hirit, të motivuar me anë të dashurisë dhe të frymëzuar me anë të besimit, ne mund ta identifikojmë veten tonë me ata që janë të humbur nga ana frymërore, ndërsa u paraqesim me hir dhe respekt mesazhin shpërsdhenës të Krishtit.

Profeti Jona në Dhjatën e Vjetër refuzoi të identifikohet me popullin e Ninives. Si rrjedhojë, ai nuk arriti të kuptojë zemrën e Perëndisë. Madje edhe kur e predikoi mesazhin, Jonas i mungonte dhembshuria dhe mëshira që shkonin me mesazhin.

Porosia e Madhe tek Mateu 28 nuk është një slogan fushate që e shpallim me të madhe për raste të veçanta. Përkundrazi, ajo duhet të jetë një mënyrë normale jetese për të krishterët. Ungjillizimi duhet të ndodhë kudo ku jetojnë dhe punojnë njerëzit e Perëndisë. Leximi fjalë për fjalë i tekstit të Porosisë së Madhe nga greqishtja është: “Ndërsa shkoni, bëni dishepuj ...”.

Kur kemi zemrën e Perëndisë dhe kur jetojmë në vullnetin e Tij, ungjillizimi do të rrjedhë nga gjithçka që bëjmë. Na vjen natyrshëm shërbimi ndaj njerëzve rreth e qark nesh si përfaqësues të Krishtit në botë.³ Me anë të fjalëve dhe veprimeve tona të hirshme, vetë jetët tona kthehen në manifestime bindëse të së vërtetës së ungjillit.

Patjetër që jemi të obliguar që jo vetëm ta shfaqim dashurinë dhe dhembshurinë e Jezusit, por edhe ta shpjegojmë atë. Ndihami për ata që janë në nevojë është biblike. Megjithatë, është po aq e rëndësishme t'iu themi njerëzve se përse i duam, përse ecim edhe dy milje me ta, përse e kthejmë faqen tjetër kur na dhemb, dhe madje pse u ofrojmë armiqve tanë për të ngrënë dhe për të pirë. Këto koncepte të ungjillit janë të çuditshme për shoqërinë tonë moderne të Perëndimit. E megjithatë, ato janë të ngjashme me parimet humanitare të cilat shumë vetë në kulturën tonë i vlerësojnë dhe i kremtojnë. Në të vërtetë, nuk ka asgjë jotolerante rreth shprehjes së mirësisë për këdo – madje edhe për ata që janë indiferentë ose armiqësorë.

Sigurisht, ungjillizimi nuk ka të bëjë me përpjekjet njerëzore. Ndryshimi i zemrave është vepra e mbinatyrshme e Perëndisë. Planet tona do të dështojnë, nëse nuk është e përfshirë Fryma e Shenjtë. Nga ana tjetër, kurdoherë që një lëvizje e Perëndisë shoqëron predikimin e ungjillit, shumë rrallë njerëzit ngrenë çështjen e tolerancës. Kur Perëndia shëron të sëmurët ose çliron dikë nga skllavëria demonike, ose kur një kriminel pendohet dhe kthehet nga paudhësia, njerëzit diskutojnë nëse i besojnë dëshmisë. Fokusi i tyre zhvendoset nga

idealet e shkencës humane tek pyetja nëse Perëndia ekziston dhe vepron në botë – dhe nëse po, çfarë duhet të bëjnë tani.

Edhe pse është e natyrshme që të gëzohemi për ata që Zoti ia shton Kishës së Tij, detyra kryesore e ungjillizimit nuk është të numërojë shifrat e të konvertuarve. Përkundrazi, ndjekësit e Krishtit duhet të predikojnë Fjalën dhe të mbështeten tek Fryma e Shenjtë për rezultatet që do arrihen. Ungjillizimi është një aktivitet frymëror i kishës. Si i tillë, të krishterët kanë nevojë për fuqizimin e Frymës së Shenjtë për ta bërë këtë detyrë. Ky është mësimi që marrim nga libri i Veprave të Apostujve dhe nga Letrat. Të krishterët e hershëm, pavarësisht nëse po dëshmonin përpara një audience me grekë, romakë apo hebrenj, mbështeteshin tek Fryma e Shenjtë që Ai t'i prekte zemrat dhe jetët e dëgjuesve të tyre. Fryma e Shenjtë i kapërcen kufijtë kulturorë dhe komunikon zemrën e Perëndisë tek zemrat e njerëzve.

Pavarësisht nga sfidat që ndeshim në kulturën tonë të ndryshueshme, nuk duhet ta heqim dhembshurinë e Krishtit nga shërbesa jonë. Ta themi të vërtetën me dashuri është themeli i ungjillizimit të krishterë. Përpjekja për ta modifikuar mesazhin për ta bërë ungjillin të tingëllojë i pranueshëm do t'ia ndryshonte vetinë e tij dalluese (të cilën, një shoqëri vërtet “tolerante” duhet të na inkurajojë që ta ruajmë). Në të njëjtën kohë, veprimi me një qëndrim tjetër përveç dashurisë për hir të të siguruarit të një pozicioni dominues ose superior e zhvesh ungjillizimin nga fuqia e tij.

Historia e Kishës është e mbushur me shembuj që vërtetojnë efikasitetin e këtij ekuilibri biblik e të përqendruar tek Perëndia. Ungjillizimi i vërtetë fillon dhe mbaron me dashurinë, dhe midis këtyre dy skajeve njerëzit ndeshen me mesazhin jetëndryshues të Jezusit.

Shënime

1. Jean Bethke Elshtain, “Do Not Be Afraid! The Call to Evangelism and Christian Intellectuals,” *Word & World*, 25 nr. 2 (Pranverë 2005): 172–179.
2. Po aty.
3. K.H. Ding, “Evangelism as a Chinese Christian Sees It,” *Missiology: An International Review*, 11, nr. 3 (korrik 1983): 314–316. Leksion i dhënë në universitetin “Uppsala”, në qytetin Uppsala, Suedi, 2 nëntor 1982.



JOSEPH DIMITROV, president i Seminarit Teologjik Kontinental, Sint-Pieters-Leeuw, Belgjikë



KOLEGJI TEOLOGJIK UNGJILLOR

...sepse Perëndia i të korrave vazhdon të thërrasë punëtorë!

Pastor, a keni nevojë që të zhvilloni bashkëpunëtorë frymërorë dhe të aftësuar në kishën tuaj? Lejoni që KTU të ndihmojë! KTU ekziston që...

- të përgatisë mbjellës kishash, pastorë, misionarë dhe shërbëtarë të tjerë me dijen e Fjalës së Perëndisë dhe me një shërbesë të efektshme në një kontekst pentakostal
- të mësojë teologji të shëndoshë dhe të zhvillojë udhëheqës shërbëtorë
- të avancojë ungjillin dhe të themelojë kisha pentakostale dhe të tjera ungjillore midis shqiptarëve dhe më gjerë në të tërë botën

...dhe është duke e përmbushur këtë qëllim. Pas dhjetë vitesh investimi në përgatitjen e shërbyesve, jemi duke parë frute. Pesëdhjetë të diplomuar janë duke ndikuar për Krishtin në shumë vende të Shqipërisë, Kosovës dhe të Maqedonisë si dhe në kombe të tjera jashtë vendit.

Në KTU, studentët do të mësojnë rëndësinë e formimit transformues të karakterit, të jetës së krishterë në komunitet, doktrinës së shëndoshë, mësimi të mirë biblik, teologjik, misiologjik, si dhe përgatitjes së balancuar dhe serioze për shërbesë. KTU nuk është një shkollë dishepullizimi për besimtarë të rinj. Kjo është një shkollë biblike e një niveli universitar për ata që janë të thirrur për shërbesë.

Dërgimi i një studenti në KTU kërkon besim, përkushtim dhe sakrificë, por ju garantojmë që ia vlen të investosh. A dëshironi që shërbesa juaj të rritet? Atëherë mbillen farën në training. Në drejtues-misionar ka thënë, "Ai që trainon më shumë, korr më shumë shpirtëra të humbur." Bëni një hap besimi dhe do të shikoni çfarë Perëndia do të bëjë!

Për më shumë informacion, kontaktoni:

ktu@icc-al.org ♦ Cel.: 069-40-68956





ÇMIMI I LARTË I TË QENIT TË HUMBUR

(dhe Çfarë Mund të Bëjmë rreth Kësaj)

Nga: ALAN R. JOHNSON

Ndërkohë që meditojmë se sa i dhimbshëm është gjykimi i përjetshëm, kisha nuk mund ta hedhë tutje këtë fakt për shkak të parehatisë së saj apo për shkak se jo të krishterët tallen me këto terma. Reagimi ynë ndaj sfidës për të arritur të humburit duhet të fillojë që tani.

*Sepse Biri i njeriut erdhi të kërkojë dhe të shpëtojë atë që kishte humbur
(Luka 19:10).*

*Krishti Jezus erdhi në botë për të shpëtuar
mëkatarët... (1 Timoteut 1:15).*



ulëm në një oborr në murin
e jashtëm të një tempulli të
famshëm. Isha me disa miq
të cilët më kishin ftuar t'iu
bashkohesha në punën
kërkimore rreth njerit prej

grupeve të njerëzve më të paarritur në të gjithë
botën. U ula duke pasur përballë rreth 200 deri 300
të moshuar të cilët po bisedonin me gjallëri. Pas
nesh ndodhej një faltore. Aty mësuam se njerëzit
kalonin një muaj në kryeqytet duke bërë rituale
fetare përpara se të ktheheshin nëpër fshatrat e
tyre. Ishte një moment thellësisht prekës për të
gjithë ne, kur realiteti na goditi me shumë forcë, se
këta njerëz të moshuar ishin përtej arritjes së
çfarëdo dëshmie të krishterë.

Afër fundit të jetëve të tyre, duke jetuar në një grup
njerëzish që kishin një nga kontaktet më të pakta me
ungjillin në botë, ata përballeshin me përjetësinë pa
pasur asnjë njohuri për mesazhin shpëtues të
Jezusit.

Kam kaluar pothuajse njëzet e tetë vjet duke jetuar
në mesin e një populli budist, popullsia e të cilëve
përfshin vetëm 0.3 për qind të të krishterëve
ungjillorë të çdo lloji. Rreth e përqark meje ka miliona
njerëz të cilët nuk kanë takuar akoma ndonjë të
krishterë dhe as nuk kanë dëgjuar një prezantim të
përshtatshëm të ungjillit. Izolimi nga mesazhi i
krishterë nuk përbën një koncept intelektual me
interes akademik për mua. Ajo që më shqetëson
është gjendja e humbur frymërore e njerëzimit. Ka
ditë kur kjo gjendje bëhet mbytëse.

Atë ditë, ndërsa u larguam nga oborri, sytë e mi u
mbushën me lot dhe zemra ime sa vinte e rëndohej
në lutje. Në botën e sotme, t'iu referohesh njerëzve
të humbur dhe të ndarë nga Perëndia nuk është
shumë e përhapur, sidomos në perëndim. Ata, të
cilët deklarojnë që çdo udhë të çon tek Perëndia, do
ta quanin të pavend detyrën që unë ndiej për këta
njerëz. Shkrimi i jep përgjigje kundërshtimeve dhe
pyetjeve të të krishterëve dhe të jo të krishterëve po
ashtu. Duhet të kthehemi tek Bibla për të parë se
ç'do të thotë të jesh i humbur dhe si duhet të
reagojmë ndaj një bote të humbur.

ÇMIMI I LARTË I TË QENIT TË HUMBUR

Kur Jezusi e përkufizoi arsyen e Tij për ardhjen në
botë me qëllimin "për të kërkuar dhe për të shpëtuar
të humburit", ai i dha formë, në mënyrë të saktë,

misionit të Tij me ide që janë qendrore ndaj besimit të Biblës. Bibla na mëson se Perëndia i krijoi njerëzit sipas imazhit të Tij për t'u kënaqur në marrëdhënie me Të. Rebelimi njerëzor e prishi atë marrëdhënie. Nga perspektiva e Perëndisë, ne jemi të humbur. Ne u larguam nga qëllimi i planifikuar i përjetimit të një marrëdhënieje me Perëndinë dhe nga synimi ynë i fillimit, i të jetuarit në praninë e Tij si populli i Tij. Për shkak se gjendja jonë frymërore erdhi si pasojë e zgjedhjes sonë të lirë, jemi të prekur nga gjykimi për mëkatit dhe për rebelimin tonë. Të jesh i humbur gjithashtu do të thotë që ke nevojë për shpëtim nga gjykimi.

Pikëpamja biblike që e sheh njerëzimin si të humbur, të ndarë nga Perëndia dhe në nevojë për shpëtim dhe çlirim nga gjykimi, është në zemër të projektit shpengues të Perëndisë. Gjithashtu, ky është edhe pozicioni themelor për ta kuptuar Shkrimin në tërësi. Kris Rajt (Chris Wright), autor dhe teolog, thotë: “E gjitha Bibla mund të portretizohet si një përgjigje shumë e gjatë e një pyetjeje shumë të thjeshtë: Çfarë mund të bëjë Perëndia rreth mëkatit dhe rebelimit të racës njerëzore?”¹

Libri i Zanafillës na tregon jo vetëm se si u bë i humbur njerëzimi, por gjithashtu edhe çmimin e lartë të rënies së tij. Kur Adami dhe Eva nuk iu bindën Perëndisë, kishte pasoja të cilat janë kohore (të cilat i përkasin botës materiale – shënim i redaktorit) dhe frymërore. Tek kapitulli 3 i Zanafillës, rënia i shkatërron të gjitha dimensionet e jetës njerëzore – dimensionin frymëror me Perëndinë, atë social me njerëzit e tjerë, si edhe atë mjedisor me krijimin.

Rajt vëren se Zanafilla 3-11 zbulon infrastrukturën bazë të projektit të krijimit të Perëndisë dhe elementet e hirit të Tij. “Por në një nivel tjetër, çdo gjë rrëshqet tragjikisht nga mirësia fillestare e qëllimit të Perëndisë”, - thotë ai. “Toka gjendet nën verdiktin e mallkimit të Perëndisë për shkak të mëkatit njerëzor. Ndërsa brezat kalojnë, qeniet njerëzore po i shtojnë katalogut të tyre të ligësisë, xhelozinë, inatin, vrasjen, hakmarrjen, dhunën, korrupsionin, dehjen, çrregullimet seksuale, arrogancën.”²

Problemet që shohim në kapitujt e parë të Zanafillës, si dhe në shoqëritë tona sot, janë simptomat që rrjedhin nga një marrëdhënie e prishur me Perëndinë. Fakti që jemi të humbur nga aspekti frymëror, sjell pasoja të frikshme për cilësinë e jetës njerëzore. Pali thotë se, përvoja aktuale njerëzore zbulon zemërimin e Perëndisë (Romakëve 1:18), dhe se njerëzit korrin rezultatet e veprimeve të tyre në këtë jetë (Romakëve 1:24–32).

Pavarësisht se janë kohore, gjykimi dhe fryti i sjelljes mëkatore në këtë jetë paralajmërojnë pasoja frymërore akoma më të rënda. Në kopshtin e Edenit, Perëndia i paralajmëroi Adamin dhe Evën se pasoja e mosbindjes do të ishte vdekja (Zanafilla 2:17). Ndërsa shqyrtojmë ngjarjet përgjatë historisë së Biblës, Fryma e Shenjtë na tregon në mënyrë progresive gjithnjë e më shumë rreth vdekjes frymërore dhe Ditës së Gjykimit për mëkatet. Shpresa e të drejtit dhe fati i të ligut fillojnë që të marrin formë në Dhjatën e Vjetër. Kur arrijmë në

kohën e Dhjatës së Re, ekziston një pritshmëri për ardhjen e një dite të zemërimit - duke filluar me predikimin e Gjon Pagëzorit te Mateu 3:7.

Por, pikërisht në vetë fjalët e Jezusit gjejmë mësim më të qarta rreth Gjykimit të Fundit. Duke përdorur një shumëllojshmëri imazhesh, Jezusi flet rreth ferrit dhe gjykimit si realitete të tmerrshme.



ARRITJA E GRUPEVE TË NJERËZVE TË PAARRITUR

Nga Shkrimi e dimë që Perëndia do çdo person në botë. Ai nuk dëshiron që dikush të humbasë (2 e Pjetrit 3:9).

Ideja themelore e detyrës së popullit të Perëndisë, kishës, është që t'i shpallë gjithë botës shpëtimin e Tij të mahnitshëm. Në këtë kuptim, i gjithë ungjillizimi është i barabartë, sepse gjithkush ka nevojë për mesazhin shpëtues.

Por ekziston një kuptim tjetër në të cilin i gjithë ungjillizimi nuk është i barabartë. Kjo ndodh sepse megjithëse që të gjithë njerëzit janë barabar të humbur nga ana frymore, jo që të gjithë kanë qasje të barabartë ndaj ungjillit. Disa grupe njerëzish nuk kanë asnjë të krishterë dhe asnjë kishë në mesin e tyre që të ndajë ungjillin në një mënyrë të përshtatshme.

Mendimtarët e misionit i quajnë të krishterët që kanë të njëjtën gjuhë dhe kulturë “dëshmitarë të fqinjësisë së afërt”. Ungjilli udhëton më shpejt me anë të dëshmitarëve të fqinjësisë së afërt, por kur nuk ka asnjë të krishterë në mesin e një populli (ose ka aq pak saqë shansi për t'u takuar me një dëshmitar të krishterë është shumë i ulët) atëherë mund të vijë dëshmitarë ndërkulturore, të jetojnë mes tyre, të ndajnë ungjillin dhe të mbjellin një kishë.

Barrierat që nuk i lejojnë njerëzit të marrin lajmin e mirë, edhe kur ata jetojnë gjeografikisht pranë të krishterëve, janë kuptimi dhe pranimi. Këto pengesa kulturore përfshijnë gjuhën, kastën dhe pikëpamjet fetare, ndër të tjera.

Ata që studiojnë misionin global të kishës arrijnë të kuptojnë se edhe pse kisha ekziston në pothuajse çdo shtet legjitim në botë, ajo nuk është e pranishme në shumë prej grupeve gjuhësore kulturore që banojnë në këto kombe. Në këto grupe njerëzish mungojnë dëshmitarët e fqinjësisë së afërt, të cilët mund ta ndajnë mesazhin e Jezusit në një mënyrë të përshtatshme përmes fjalëve dhe veprave.

Pjesa tjetër e Dhjatës së Re qëndron tek e njëjta pamje. Si pasojë e natyrës mëkatore të njerëzve, ne jemi objekte të zemërimit (Efesianëve 2:3). Do vijë koha për këtë zemërim (Romakëve 5:9; 1 Thesalonikëve 1:10). Paga e mëkatit është vdekja (Romakëve 6:23). Njerëzit janë të destinuar të vdesin një herë dhe më pas, të përballen me gjykimin (Hebrenjve 9:27). Ekziston një Ditë Gjykimi dhe shkatërrimi i

Mendimtarët e misionit kanë rënë dakord për termin “grup njerëzish të paarritur”¹ për t’i përshkruar këta banorë. Këto grupe nuk kanë asnjë komunitet vendas me besimtarë të krishterë të cilët të kenë burime të përshtatshme për të ungjillizuar pjesën tjetër të komunitetit që nuk ka ndihmë të jashtme ndërkulturore.

Është e rëndësishme të mbajmë mend se fjala “të paarritur” në këtë kuptim është një term teknik për t’iu drejtuar njerëzve që kanë pak ose aspak qasje ndaj ungjillit në një mënyrë që ata të mund ta kuptojnë dhe pranojnë. Nuk është një sinonim për njerëzit e humbur në përgjithësi. Sipas përkufizimit, një grup që ka shumë persona jo të krishterë dhe një komunitet vendas të gjallë dëshmitarësh nuk është një grup njerëzish i paarritur.

Ekspertët thonë se, aktualisht, nga 2.91 miliardë njerëz në më shumë se 7 mijë grupe të ndryshme popullatash janë më pak se 2 për qind të krishterë ungjillorë. Në po këtë popullsi, më pak se 5 për qind kanë një formë të besimit të krishterë në mesin e tyre. Këta njerëz jetojnë kryesisht në blloqet e feve myslimane, hindusite dhe budiste. Sipas përlogaritjeve, 86 për qind e tyre nuk njohin asnjë të krishterë.²

Kjo është sfida e madhe e misionit ndërkulturore të kohës sonë. Ekziston nevoja për të vendosur punëtorë me mëngë të përveshura në mesin e këtyre grupeve njerëzish që kanë shumë pak qasje ndaj ungjillit. Evropa e post-krishtërimit ka njëzet vende të cilat janë më pak se një për qind ungjillorë. Dhe pjesa më e madhe e botëve myslimane, hinduiste dhe budiste ose nuk kanë fare qasje ose e kanë qasjen shumë të kufizuar ndaj ungjillit, të krishterëve dhe kishave. Këto segmente të mëdha të njerëzimit përfaqësojnë mbi 40 për qind të botës sonë dhe detyrën misionare më të vështirë dhe më të komplikuar.

Kur vjen puna tek njerëzit e humbur nga ana frymërore të cilët nuk kanë qasje ndaj ungjillit, bërja e projekteve të dobishme nuk mjafton. Situata kërkon punëtorë në terren të cilët të kenë aftësi gjuhësore dhe kulturore për të treguar historinë e Jezusit. Për këtë arsye, mua më pëlqen të them që, për grupet e njerëzve të paarritur, punëtori është projekti. Perëndia po thërret punëtorë që t’i shpenzojnë jetët e tyre në mesin e njerëzve të paarritur. Kush do t’i dërgojë?

ALAN R. JOHNSON

Shënime

1. <http://www.beyond.ag.org>
2. <http://www.joshuaproject.net/>

njerëzve të paperëndishëm (2 Pjetrit 2:9).

Libri i Zbulesës zbulon një fron përfundimtar të madh e të bardhë të gjykitimit për ata që e refuzojnë Jezusin (Zbulesa 20:11–15).

Interpretuesit e singertë pentekostalë, të cilët e marrin seriozisht Biblën, mundohen si t’i kuptojnë këto tekste që mësojnë rreth ferrit. Këto të vërteta janë të pakuptueshme nga ana e përvojës sonë njerëzore. Përballë realiteteve të përjetësisë, gjuha njerëzore dështon dhe arrijmë në limitet e të kuptuarit tonë. Imazhet, shumica e të cilave janë thënë nga vetë Jezusi, janë shumë të fuqishme: furra e zjarrtë, zjarri që nuk shuhet, krimbi që nuk vdes, errësira, qarja dhe kërcëllimi i dhembëve, zjarri i përjetshëm i përgatitur për djallin dhe engjëjt e tij, dënimi i përjetshëm, liqeni i zjarrtë, dhe ndarja nga prania e Zotit. Ata studiues të cilët nuk bien dakord për detajet, zakonisht bien dakord se ferri është një vend i një mjerimi të papërshkrueshëm, por që Bibla është më shumë e shqetësuar për të prezantuar seriozitetin e gjykitimit që është duke ardhur sesa të shpjegojë natyrën e hollësishme të ferrit.³

Gjendja e humbur e njerëzve të ndarë nga Perëndia dhe ardhja e gjykitimit të tyre janë të vërteta biblike që ngrenë shumë pyetje dhe janë të parehatshme. Ata që nuk janë të krishterë tallen me këto nocione, ndërsa të krishterët i shpërfillin gjithnjë e më shumë mësimet e Biblës mbi ferrin dhe parajsën. Disa persona që identifikohen si të krishterë pentekostalë nuk besojnë më se Perëndia do t’i gjykojë ata që e refuzojnë ungjillin, duke qenë se, sipas pikëpamjes së tyre, ka një mori mënyrash efikase që njerëzit ta njohin Perëndinë dhe të jetojnë përjetësisht me Atë.

Ideja se njerëzit janë të humbur në aspektin frymëror dhe se do të përballen me gjykimin e Perëndisë i ofendon jo të krishterët, të cilët e shohin këtë si një arsye për të sulmuar karakterin e Perëndisë. Ata iu referohen mësimave biblike për ferrin sikur këto të ishin një e metë morale e Perëndisë, duke e quajtur Atë një torturues sadist sepse i dënon njerëzit me vuajtje të vetëdijshme në përjetësi.

Në një mjedis të tillë, Kisha duhet të përmbushë detyrat e saj për ta artikuluar qartë besimin biblik. Kemi nevojë për udhëheqjen dhe urtësinë e madhe nga Fryma e Shenjtë ndërsa i angazhojmë jobesimtarët me të vërtetën biblike.

Ndërsa meditojmë se sa i dhimbshëm është gjykimin e përjetshëm, ne nuk mund ta hedhim tutje këtë ide për shkak të parehatisë sonë. Neglizhimi i këtyre të vërtetave i nënçmon të gjitha ato që thotë Bibla rreth Perëndisë, mëkatit dhe veprës së Jezusit në kryq. Duhet të kujtojmë se ndërsa Bibla është shumë e qartë për sa i përket gjykitimit, po ashtu ajo është shumë e qartë edhe për dy gjëra të tjera: lirinë njerëzore dhe përpjekjet e mëdha që ka bërë Perëndia për ta sjellë shpëtimin tek ne. Personat që bëjnë pyetje të vështira me singëritet, duhet të inkurajohen që të shohin provat biblike rreth zgjedhjes së njeriut. Gjoni na kujton se Jezusi “erdhi në shtëpinë e vet dhe të vetët nuk e pranuan” (Gjoni 1:11) dhe se ndërkohë që drita ka ardhur në botë

*Gjendja e humbur e botës
nuk duhet të na paralizojë
deri në mosveprim.*

*Përkundrazi, madhështia e
shpëtimit të Krishtit duhet
të na mobilizojë që t'i
shpallim kombeve atë që Ai
ka bërë.*



“njerëzit deshën errësirën më tepër se dritën, sepse veprat e tyre ishin të mbrapshta” (Gjoni 3:19). Pali na tregon se njerëzit e “mbysin të vërtetën në padrejtësi” dhe se ata nuk kanë justifikim sepse kanë refuzuar njohurinë për Perëndinë që iu është dhënë në krijim (Rom. 1:18-20). Libri i Zbulesës zbulon se edhe në mes të gjykimeve të tmerrshme, njerëzit që do jetojnë në ditët e fundit nuk do të “pendohen nga veprat e duarve të tyre” (Zbulesa 9:20).

Një studiues thotë se ferri është prova se sa shumë e vlerëson Perëndia lirinë e njeriut; në fund të fundit, Ai nuk do t'i detyrojë njerëzit të jetojnë me Të përjetësisht në praninë e Tij, nëse ata nuk duan të jenë aty.⁴ Bibla, ndërkohë që është shumë realiste rreth gjendjes së njerëzimit, është një libër që flet për shpresën dhe për një shpëtim të pasur që iu është ofruar të gjithëve. Reagimi ynë ndaj të humburve frymërorë është i rrënjësor tek reagimi i Perëndisë.

ÇFARË MUND TË BËJMË SOT PËR TË HUMBURIT?

Për njerëzit që i besojnë mësimet e Biblës rreth njerëzimit të humbur, detyra mund të duket e pakalueshme. Ata mund të vrasin mendjen nëse përpjekjet e tyre mund të sjellin ndonjë ndryshim apo madje nëse ia vlen që të shqetësohen për t'u përfshirë në këtë çështje. E megjithatë, të njëjtat tekste biblike që flasin për gjykimin deklarojnë gjithashtu se Perëndia ka dhënë një rrugë shpëtimi nga mëkati; mëkatari mund të pajtohet me Perëndinë e gjallë. Këto premtime tejet motivuese më mbajnë të angazhuar me njerëzit e humbur.

Bibla është e gjitha për lajmin e mirë. Është historia madhështore që i jep kuptim të gjitha gjërave, duke na siguruar se një ditë Perëndia do t'i vendosë gjërat në rregull (Efesianëve 1:10). Jezusi e dha jetën e Tij si shpengim për shumë veta (Marku 10:45). Ai na thërret që të jemi ndihmë në misionin e Tij për të kërkuar dhe shpëtuar të humburit. Ai tha se Ati qiellor nuk është i gatshëm që dikush të humbasë (Mateu 18:14) dhe se do të ketë shumë gëzim në qiell për një mëkatar që pendohet (Luka 15:7,10). Përmes veprës së Tij në kryq, Jezusi na shpengon nga zemërimi që do të vijë (Rom. 5:9; 1 Thesalonikasve 1:10). Pali thotë se Jezusi erdhi në botë për të shpëtuar mëkatarët (1 Timoteut 1:15). Lajmi i mirë është se Jezusi e shkatërroi vdekjen dhe solli në dritë jetën dhe pavdekësinë përmes ungjillit (2 Timoteut 1:10). Perëndia na ka besuar një mesazh të mrekullueshëm për t'ia treguar botës.

Gjendja e humbur e botës nuk duhet të na paralizojë deri në mosveprim. Përkundrazi, madhështia e shpëtimit të Krishtit duhet të na mobilizojë që t'i shpallim kombeve atë që Ai ka bërë.

Ashtu si me brezat e mëparshëm, përhapja e këtij lajmi të mirë për të humburit, gjeografikisht dhe kulturisht, afër dhe larg, është zemra e misionit pentekostal. Veprat 1:8, që premtan fuqizimin nga Fryma e Shenjtë për të dëshmuar deri në skajet e dheut, ka një vend të veçantë në historinë e misionit pentekostal dhe mbetet shumë aktuale për kishën e sotme.

Sot jemi më të ndërgjegjshëm se kurrë që edhe pse të gjithë njerëzit janë të humbur në mënyrë të barabartë, jo të gjithë kanë mundësi të barabarta për të dëgjuar lajmin

e mirë. Ata që studiojnë gjendjen e besimit të krishterë mes grupeve të ndryshme të popullsisë së botës përlogarisin se 86 për qind e popullsisë Budiste, Myslimane dhe Hinduiste nuk njohin asnjë të krishterë.⁵

Çfarë mund të bëjmë në këtë moment të historisë sonë? Megjithëse njerëz të humbur ka kudo përqark nesh, disa grupe kanë më pak mundësi për të dëgjuar ungjillin dhe kanë nevojë për një vëmendje të veçantë. Unë besoj se mund të kemi një ndikim strategjik në mesin e tri grupeve specifike të njerëzve të humbur, të cilët përfaqësojnë sfidat e mëdha të misionit të kohës sonë për të dëgjuar lajmin e mirë.

1. Numri gjithnjë e në rritje i atyre që janë të zhgënjyer me fenë e organizuar. Sondazhet fetare tregojnë se shumë njerëz nuk kanë një preferencë fetare për sa i përket përfshirjes me një fe, dhe numri i atyre që janë të zhgënjyer me kishën vazhdon të rritet.⁶ Nuk është e mjaftueshme që thjesht të “shkëmbejmë shenjtoret” rreth nesh ndërkohë që njerëzit e zhgënjyer largohen gjithnjë e më shumë nga besimi i krishterë. Këta njerëz nuk janë duke lundruar nëpër faqet tona të internetit dhe as duke vizituar shërbesat tona. Duhet t'i gjejmë dhe të zhvillojmë marrëdhënie shpenguese dhe të përzierme me ta.

2. Grupet e ndryshme të njerëzve nga e gjithë bota. Vendet e botës kanë ardhur në Evropë dhe Amerikë. Shumë prej tyre janë nga vende ku ka shumë pak mundësi për ta dëgjuar ungjillin. Këta janë të humburit të cilët janë kulturisht larg, por gjeografikisht afër nesh. Kush do të dalë nga zona e tyre e rehatisë për të arritur këta njerëz me dashuri?

3. Grupet etnolinguistike me pak ose aspak mundësi për të dëgjuar ungjillin. Një prioritet misioni strategjik ndërkulturore duhet t'i nxisë punëtorët e terrenit që të jetojnë dhe të jenë dëshmi në mesin e atyre njerëzve në botë të cilët kanë mundësi të pakta për ungjillin, midis atyre që janë gjeografikisht dhe kulturisht larg nesh. Ky është momenti në të cilin jetojmë. Perëndia na ka thirrur tek Ai për një qëllim. Megjithatë, ngulmimi dhe bërja e punës së vështirë për arritjen e botës kërkon një vizion të ripërtërirë biblik të të humburve nga ana frymërore dhe një nxitje mbinatyrore nga Fryma e Shenjtë për të bërë diçka për t'i ndihmuar ata.

TË HUMBURIT DHE NEVOJA JONË PËR VEPRËN E FRYMËS

Te Zanafilla 3:9, Perëndia i thirri Adamit: “Ku je?”

Këto fjalë zbulojnë zemrën kërkuese të Perëndisë për fëmijët e Tij të humbur. Pikërisht këtu duhet të fillojë reagimi ynë ndaj sfidës për të humburit. Fryma na bën bashkëpunëtorë me Perëndinë trini dhe derdh brenda nesh pasion hyjnor dhe dëshirë për njerëzimin e humbur.

Nuk vjen natyrshëm përkujdesja për mirëqenien frymërore dhe të përfjetshme të të tjerëve. Ajo që vjen natyrshëm është përkujdesja për nevojat tona, dhe për ato të familjarëve dhe miqve tanë. Por është një vepër e Frymës së Shenjtë për t'i ndryshuar zemrat tona që të ndjekin shembullin e Tij për të kërkuar të angazhohemi me njerëzit e humbur, pavarësisht kostos. Kohët e fundit po rishikojmë historinë tonë pentekostale të misionit si material sfondi historik për një detyrë me shkrim. Një gjë që më bëri përshtypje menjëherë ishte logjika e thjeshtë që pentekostalët e hershëm kishin rreth misionit. Sipas këndvështrimit të tyre, Fryma vjen që të kemi fuqi për ta çuar ungjillin në pjesët më të skajshme të tokës – tek çdo fis, gjuhë dhe komb.

Kjo gjë më bëri të mendoj se çfarë do të ndodhte nëse do i riktheheshim asaj thjeshtësie dhe nëse do ta zvogëlonim veten sa fokusi i një lazeri për ta çuar ungjillin tek njerëzit e humbur në shkallë vendore dhe tek fiset dhe gjuhët në shkallë globale, të cilët kanë më pak qasje ndaj lajmit të mirë. Unë besoj se kjo do të na ripërtërinte. Përse? Sepse do të na thyente. Me fuqinë tonë – thjesht nuk mund ta bëjmë – as me milionat tona, as me krahun e punës, as me teknologjinë e as me teknikat tona. Nuk e dimë se si ta bëjmë, dhe do të vdesim duke u përpjekur për ta bërë. Kjo do të na nxisë të pendohejmë për idhujtarinë tonë ndaj aftësisë njerëzore dhe teknologjike dhe do të biem përmbys përpara Perëndisë për të kërkuar mëshirë, fuqi dhe strategji hyjnore nga Fryma.

Për të arritur njerëzit e humbur në ditët e sotme, kemi nevojë që Fryma e Shenjtë të na mbushë nga e para. Duhet të bëhemi njerëz që janë pentekostalë nga dëshpërimi për shkak se tani e dimë që detyrat më të vështira dhe më tmerruese mbeten. Sfidat për të arritur ata persona në shoqërinë tonë të cilët janë të zhgënjyer, si dhe popujt në botë të cilët kanë shumë pak qasje ndaj ungjillit, na tendos përtej aftësisë sonë njerëzore.

Një fokus i ngushtë për të humburit do të na ripërtërijë ndërkohë që zelli i Frymës për njerëzimin e humbur çliron fuqinë shumëfishuese dhe unifikuuese të një vizioni të rrënjësor thellë në zemrën e Perëndisë. Ajo do të na japë një qëllim që është më i madh sesa dëshirat dhe axhendat personale. Kur njerëzit thyhen për të humburit që janë gjeografikisht dhe kulturalisht larg tyre, do të fillojnë t'i shohin me një sy tjetër të humburit që jetojnë në hyrjen apo pallatin ngjitur. Njerëzit që janë të zjarrtë për të arritur grupet e njerëzve të paarrtur do të fillojnë t'i shohin ndryshe fqinjët e tyre, ndërsa njerëzit që fillojnë të angazho-

hen me fqinjët e tyre do t'i kuptojnë më mirë komplikitet për arritjen e njerëzve të humbur në të gjithë globin. Prioriteti kritik i punëtorëve që kanë përveshur mëngët në mesin e njerëzve të paarrtur do të bëhet i qartë.

Unë kam një ëndërr të marrë. Në SH.B.A. kemi pothuajse 13 mijë kisha të Asambleve të Perëndisë. Gati të gjitha këto takohen në ndërtesa që janë marrë me qira ose janë blerë. Çfarë do të ndodhte nëse një lëvizje e Frymës – jo e nxitur nga pastorët, as e programuar apo e shtyrë, por thjesht që vepron në zemrat e njerëzve – t'i kthejë këto gati 13 mijë objekte në shtëpi lutjeje për kombin e tyre dhe për kombet? Çfarë do të ndodhte nëse njerëzit do t'i rrëfenin fajet e tyre, do të pendoheshin për idhujtarinë e tyre dhe do të pranonin paaftësitë e tyre për të sjellë tek Krishti fqinjët e tyre të humbur, grupet e ndryshme kulturore brenda kombit të tyre dhe popujt e paarrtur rreth e përqark botës?

Të luten, të tregojnë, të dërgojnë: Ky është reagimi që Fryma e Shenjtë ka trazuar gjithmonë tek populli i Tij ndërsa i tërheq për të marrë pjesë në misionin e Perëndisë. Të krishterët që ishin me mua atë ditë në oborr ishin për shkak të një nxitjeje të fuqishme që ndjenë nga Fryma e Shenjtë. Ata janë duke i mbuluar ata njerëz me lutje dhe janë duke punuar aktivisht për të pajisur dhe dërguar punëtorë të cilët do të jenë të aftë nga pikëpamja gjuhësore dhe kulturore për të treguar historinë e Jezusit.

Nëse për ata të moshuarit që ishin në oborr është tepër vonë, ka akoma shpresë për numrin e pafund të njerëzve që fillojnë nga qyteti juaj e deri në qoshtet e globit. Ata kanë nevojë të dëgjojnë një ftesë të përzemërt për të përjetuar shpëtimin që sjell Jezusi. Ata duhet të kthehen në shtëpi tek Ati i tyre Qiejlor dhe të mos jenë më të humbur.


Shënime

1. Christopher Wright, *The Mission of God: Unlocking The Bible's Grand Narrative* (Downers Grove, Illinois: IVP Academic, 2006), 195.
2. Po aty., 198.
3. Shih William Crockett, *Four Views On Hell* (Grand Rapids, Michigan: Zondervan, 1996), 29–31, dhe Stephen H. Travis, “Judgment” tek *Dictionary of Jesus and the Gospels*, red. Joel B. Green, Scot McKnight dhe I. Howard Marshall, (Downers Grove, Illinois: InterVarsity Press, 1996), 408–411.
4. Crockett, *Four Views*, 142.
5. Todd M. Johnson dhe Kenneth R. Ross, red., *Atlas of Global Christianity 1910–2010* (Edinburgh: Edinburgh University Press, Center for the Study of Global Christianity, 2009), 316.
6. Shih <http://www.usatoday.com/story/news/nation/2012/10/08/nones-protestant-religion-pew/1618445/>. Për një vështrim më të detajuar rreth tablosë fetare në Amerikë, shih Putnam dhe Campbell, *American Grace*.



ALAN R. JOHNSON është një misionar në Tajlandë, dhe ka shërbyer atje që prej vitit 1986.

RRJETA E MBRETËRISË:



Të Mësojmë që të
Krijojmë Rrjetin Tonë të
Marrëdhënieve Ashtu
sìç Bëri Jezusi

Nga: JOSEPH L. CASTLEBERRY

**MERRNI NË KONSIDERATË KËTO MENDIME RRETH ARSYEVE
FRYMËRORE, TEOLOGJIKE DHE PRAKTIKE QË DUHET T'I ZOTËRONI
NË ARTIN E RRJETËZIMIT.**

"Pastorët" nuk

marrin vesh fare nga biznesi". Deklaratat e tilla i kam dëgjuar aq shpesh saqë nuk më çudisin më, edhe pse akoma mund të më acarojnë. Një akuzë e tillë e hiperbolizuar ndaj profesionit tim, shpeshherë do të pasohet nga një koment vetëmbrojtës nga ana ime. Por fakti qëndron që (dhe kjo ma prish shumë qejfin) më duhet t'i përmirësoj aftësitë e mia të biznesit nëse dua t'i bindem thirrjes së shërbesës sime dhe nëse dua që përmes saj të arrij të ndikoj sa më shumë që të jetë e mundur.

Ekziston një fushë e veçantë e aftësive të biznesit e cila ka potencial shumë të madh për ta rritur performancën e një shërbestari, dhe kjo fushë është krijimi i lidhjeve (rrjetëzimi). Askush nuk mund të drejtojë me sukses një biznes të caktuar ose një punë profesionale pa themeluar një rrjet marrëdhëniesh i cili do të shërbejë për t'i njohur njerëzit me disponueshmërinë e mallrave apo shërbimeve për të cilat ata kanë nevojë. Ky fakt i aplikohet po aq shërbesës kishtare, ndoshta edhe më fuqishëm, sa edhe çdo lëmi tjetër të punës, duke qenë se marrëdhëniet (lidhjet) janë pjesë e natyrës së mbretërisë së Perëndisë. Me qëllim që të funksiononi me sukses në mbretërinë e Perëndisë, duhet të keni aftësi të mira të rrjetëzimit.

Pasi kalova disa vjet duke studiuar dhe duke mprehur aftësitë e mia të rrjetëzimit për të përmirësuar bindjen time ndaj thirrjes në shërbesë, shkrova një libër, që titullohet: *"Rrjeta e Mbretërisë: të Mësojmë që të Krijojmë Lidhjet Tona ashtu siç Bëri Jezusi"*, për të ndarë me të tjerët atë që kam mësuar dhe për t'i fuqizuar ata që të kenë ndikim më të madh për Krishtin. Pjesët e mëposhtme, të shkëputura nga ky libër, duhet t'ju japin disa ide të qarta rreth arsyeve frymërore, teologjike dhe praktike të cilat duhet t'i zotëroni në artin e rrjetëzimit.

RRJETA E MBRETËRISË

Jezusi tha që mbretëria e Perëndisë i ngjan një rrjete (Mateu 13:47). Kjo thënie figurative nga Shëmbëlltyra e Rrjetës merr një kuptim të veçantë në botën e sotme të Internetit, Facebook-ut, Twitter-it, Pinterest-it, Instagram-it, mesazheve elektronike, mesazheve telefonike dhe mjeteve të tjera të rrjetëzimit shoqëror. Ndryshe nga shumë gjuhë të tjera, gjuha angleze ka një fjalë specifike për kontaktet e marrëdhënieve që janë si rrjetë: "network" (shqipëruar si 'rrjetëzim'). Duke qenë se rrjetëzimet përshkruajnë rrjetat metaforike dhe jo ato fizike, atëherë mund ta kuptojmë me saktësi se Jezusi tha: "Mbretëria e Perëndisë është një rrjetëzim". Në fakt, mua më pëlqen ta quaj mbretërinë e Perëndisë, "rrjeta e mbretërisë".

Sipas Jezusit, Mbretëria është rrjeta e Perëndisë që është hedhur në botë. Rrjeta kap edhe peshq të mirë, edhe peshq të këqij. Njerëz të singertë dhe të pasingertë, besimtarë të vërtetë dhe bashkudhëtarë pa besim, të gjithë e gjejnë veten të ngecur në rrjetë. Mbretëria e Perëndisë sjell shumë njerëz, dhe siç do ta shohim, disa prej tyre bëhen pjesë e vetë rrjetëzimit. Në fund, Perëndia do t'i ndajë se kujt i takon të rrijë në mbretëri dhe kujt jo.

Ashtu siç punonin në rrjetat e tyre peshkatarët e kohës së Dhjatës së Re, ashtu edhe Perëndia punon vazhdimisht në rrjetën e Mbretërisë duke e zmadhuar atë, duke i arnuar pjesët e shqepura, dhe duke kapur më shumë peshq. Jezusi, siç e shohim tek një tjetër thënie nga shëmbëlltyrat, iu tha dishepujve të tij: "Ndiqmëni dhe unë do t'ju bëj peshkatarë njerëzish" (Marku 1:17). Dishepujt e Jezus Krishtit shërbejnë si peshkatarët e Tij. Në fakt, shërbejnë si rrjetëzimi që Ai pozicionon për të kapur më shumë njerëz.

TË VAZHDOJMË ME PUNËN E JEZUSIT

Jezusi kishte paracaktuar që dishepujt e Tij të bënin më shumë mrekulli dhe të ungjillizonin dhe fitonin më shumë njerëz sesa ç'kishte bërë Ai gjatë jetës së Tij mbi tokë. Në fakt, dishepujt e Jezusit e kanë vazhduar veprën e Tij për 20 shekuj me radhë që prej vdekjes së Tij. Shifra numerike e mrekullive që u kryen përmes tyre dhe “rezultatet e tyre të peshkimit” shkojnë shumë përtej numrit total të njerëzve që preku Jezusi gjatë jetës së Tij në tokë. Sigurisht, e gjithë merita për arritjet tona i takon Jezusit, duke qenë se këto mrekulli u bënë përmes Tij. Dhe gjithashtu, Ai, në fakt, do t'i vjelë të gjitha fitimet. Në fund të fundit, ne jemi kompania e Tij e peshkimit. Të gjitha “prurjet e rrjetës” i përkasin Atij; edhe ai peshku i madh që na shpëtoi nga duart e u largua, edhe ata të vegjlit që për pak na ikën nga rrjeta, edhe peshqit që zëmë dhe i nxorëm në bregun e Tij.

Nëse mbretëria e Perëndisë është një rrjetë, atëherë fillimisht është një rrjetë peshkimi. Mbretëria nuk kërkon të zëvendësojë qeveritë tokësore, bizneset, familjen, shkollat, sindikatat e punëtorëve, spitalet apo ndonjë institucion tjetër të shoqërisë. Rrjeta e Mbretërisë ekziston për të zënë peshq. Megjithëse Mbretëria përfshin dhe sundon mbi çdo dimension të jetëve tona, ajo nuk mund ta reflektojë asnjëherë plotësisht dhe realisht mbretërimin e Perëndisë mbi ne, pa na angazhuar në kërkimin e Mbretit për të gjetur dhe për të shpëtuar të humburit. Rrjeta e Mbretërisë përfshin gjithmonë idenë për të pajtuar njerëzit e humbur me Perëndinë që i do. Përfundimisht, rrjetëzimi i Mbretërisë fokusohet tek afrimi i njerëzve tek Jezusi.

Mbretërinë e shohim atëherë kur shohim që njerëzit e Perëndisë afrohen së bashku nën sundimin e Krishtit dhe kur ndjejmë lidhjen tonë me ta përmes Frymës së Shenjtë, i cili na e bën Mbretin Jezus të pranishëm tek ne të gjithë. Pra, mbretëria e Perëndisë është edhe e dukshme, edhe e padukshme. Prania e Jezusit, që vepron përmes popullit të Tij, e bën atë të dukshme. Shëmbëlltyra e rrjetës e portretizon Mbretërinë si një rrjetëzim njerëzish.

PËRSE PESHKATARËT?

A e keni pyetur ndonjëherë veten se përse Jezusi thirri kaq shumë peshkatarë që të bëheshin dishepujt e Tij? Sepse ata ishin “punëtorë rrjetash”.

Nuk po përpiqem të bëj humor këtu. Në fakt, e kam seriozisht. Peshkatarët ishin pikërisht njerëzit që i duheshin Jezusit. Padyshim, dishepujt e Jezusit nuk i kuptuan shumë gjëra kur Ai i zgjodhi. Asnjëri prej tyre nuk ishte teolog i madh, shkrimtar i kualifikuar, folës publik i trajnuar apo këshillues psikologjik. Ata nuk kishin marrë mësim në asnjërin prej lëndëve që janë shumë të përhapura në kolegjet dhe seminarët biblike të ditëve tona. Por, të gjithë kishin një

kualifikim të padiskutueshëm: ishin krijues rrjetesh për kontakte (rrjetëzues).

Pjetri dhe miqtë e tij, në kuptimin më të parë të fjalës, e dinin se si funksiononin rrjetat e peshkimit. Dinin si t'i bënin ato, si t'i hidhnin në anën tjetër të varkës, si t'i përdornin në ujë, si t'i tërhiqnin në varkë dhe si t'i riparonin dhe t'i mirëmbanin në fund të ditës së punës. Por ata gjithashtu dinin diçka edhe më jetike.

Të kishe një biznes peshku të suksesshëm në Izraelin e shekullit të parë do të thoshte se nevojiteshin më shumë aftësi sesa thjesht përdorimi i rrjetave. Nevojitej gjithashtu edhe rrjetëzimi. Peshkatarët jo vetëm që dinin si t'i përdornin rrjetat, por gjithashtu dinin edhe si të punonin si skuadër. Ata dinin ta çonin peshkun në treg dhe ta shisnin. Dinin si të gjenin njerëzit për ta transportuar peshkun në brendësi të vendit dhe si ta tregtonin atë në komunitetet përreth. Ata e kuptonin mirë se si bëhej shpërndarja, reklama, shitjet, kufijtë e fitimit si dhe aspektet e tjera të veprimtarisë së punës së tyre. Sot, këta persona do t'i njihnim ndryshe si ekspertë të rrjetëzimit.


Nëse keni për qëllim të peshkoni për njerëz, atëherë duhet të dini se si t'i përdorni “rrjetat” për njerëzit. Rrjetëzimi është detyra thelbësore e Mbretërisë; por, pavarësisht këtij fakti, nuk është e zakonshme që seminarët biblike të kenë lëndë për rrjetëzimin. Unë nuk mendoj se e kam dëgjuar ndonjëherë këtë term gjatë arsimimit tim akademik prej 10 vitesh rreth shërbesës së krishterë. Për të qenë të ndershëm, fjala ‘rrjet’ nuk kishte hyrë ende në gjuhën e përditshme të kohës sime – në fillim të viteve '80-të – përveç se në transmetime të medias dhe në televizion. Por pavarësisht kësaj, si ka mundësi që ta kemi anashkaluar një aftësi të tillë kaq të rëndësishme?

Si president i një universiteti, unë shërbej si ‘krye-rrjetëzuesi’ i shkollës sime. Më pëlqen shumë kjo gjë; sidomos, duke qenë një person që jepem pas njerëzve, marr kënaqësi në mbajtjen e miqësive, kur takoj njerëz të rinj, dhe kur i thur këto marrëdhënie në një rrjet më të gjerë e më të fortë, të cilin mund ta përdorim për të përmbushur misionin tonë si universitet. Më pëlqen shumë puna ime dhe detyrat me njerëz që më jep kjo punë. Në veçanti më pëlqen shumë fakti që fryti i punës sonë lidhet në mënyrë kaq të drejtpërdrejtë me misionin e mbretërisë së Perëndisë. Por puna ime nuk ka ndonjë privilegj apo patentë rreth rrjetëzimit. Çdo ndjekës i Jezusit, pavarësisht nga puna që bën, mund ta shprehë mbretërinë e Perëndisë përmes rrjetëzimit.

THIRRJA E SHENJTË DHE LAIKE

Të gjitha vendet e punës kanë edhe dimensione laike, edhe të shenjta – pavarësisht nëse jeni pastor, shofer autobusi, avokat, punëtor fabrike, inxhinier, fermer, biznesmen, artist, doktor apo diçka tjetër.

Thirrjet e marrin shenjtërinë e tyre nga Ai i cili bën thirrjet; dhe, për shkak se Perëndia na ka thirrur të gjithëve, të gjitha thirrjet janë të shenjta. Por janë gjithashtu edhe laike (d.m.th. 'nga bota') sepse njerëzit të cilët Perëndia na ka thirrur t'i arrijmë jetojnë në botë. (Nëse e lejon profesionin tuaj të besimit t'ju bëjë të ndiheni të paretshëm apo të çuditshëm përreth njerëzve që nuk kanë të njëjtin besim në Krishtin, atëherë nuk do t'ia arrini të lejonit Perëndinë t'ju përdorë për zgjerimin e rrjetës së Mbretërisë.)



KUR PASTORËT E KALOJNË

GJITHË KOHËN E TYRE

ME TË KRISHTERË, TË JENI

TË SIGURT QË EDHE ANËTARËT E BASHKËSISË

SË TYRE DO TË BËJNË TË NJËJTËN GJË.

Një shërbetar që e sheh punën si pastor vetëm si të shenjtë dhe jo edhe si laike, do ta frenojë kishën dhe jetën personale të tij ose të saj. Një mori e madhe pastorësh e kalojnë gjithë kohën e tyre vetëm me të krishterë, duke i dënuar ata me një formë udhëheqjeje që mbetet thjesht në nivel transferimi dhe që ndoshta nuk shkon asnjëherë në nivel transformimi të vërtetë.

Sipas teorisë së udhëheqjes nga Xhejms MekGregor Bërns (James McGregor Burns), shumica e udhëheqësisë është thjesht në nivel transferimi. Me fjalë të tjera, udhëheqësit shkëmbejnë performancën e tyre me disa mallra dhe shërbime të cilat ndjekësit mund t'ua ofrojnë. Dhe kështu, një pastor ofron predikimin, koordinimin e ritualeve fetare si kungatat, dasmat, funeralet dhe shërbime të tjera, në shkëmbim të një vendi nderi në komunitet, (zakonisht) një rrogë të vogël dhe ndoshta një shtëpi pastori ku mund të jetojë. Pastorët në nivel transferimi i vënë një theks të fortë ruajtjes së traditave të kishës dhe statuskuosë (gjendjes ekzistuese). Ata shumë rrallë mund të sfidojnë dikë nga kisha e tyre të bëjë diçka të vështirë ose sakrifikuese, dhe njerëzit e kishës nuk presin që pastori të bëjë ndonjë gjë të madhe. Kisha nuk rritet, njerëzit nuk vijnë zakonisht tek Krishti përmes shërbesës së kishës, dhe askush nuk përjeton transformim. Me kalimin e kohës, popullsia e kishës sa vjen e plakët ... dhe pas disa kohësh ... zhduket.

Përkundrazi, udhëheqja në nivel transformues përqendrohet në një vizion transformues. Udhëheqësi i bën thirrje komunitetit që ata të bëjnë sakrifica dhe të rrezikojnë për të arritur vizionin. Nëse vizioni përfshin ungjillizim, kisha i bën thirrje anëtarëve të vet që të mos kalojnë kohë vetëm me të krishterë, por gjithashtu me njerëz të cilët nuk kanë hyrë ende në Mbretëri.

Kur pastorët e kalojnë gjithë kohën e tyre me të krishterë, të jeni të sigurt që edhe anëtarët e bashkë-

sisë së tyre do të bëjnë të njëjtën gjë. Madje disa kisha përpiqen shumë që t'i nxisin të krishterët të bëjnë biznes kryesisht me të krishterë të tjerë dhe të shmangin bërjen e biznesit me njerëz jashtë rrethit të tyre të krishterë. Duket si një formulë e shkëlqyer për të krijuar ndërlidhje (koordinim) midis të krishterëve, por jo një strategji e shëndetshme biznesi apo ungjillizimi.

Një miku im pastor, një ungjilltar jashtëzakonisht efikas, i kërkon gjithë stafit të tij që ata të kultivojnë miqësi me jobesimtarë. Ai e di se ata s'kanë për të sjellë kurrë njerëz tek Krishti nëse nuk flasin me njerëz të cilët nuk e njohin Krishtin. Si pjesë e raportimeve të punës, ata duhet të përshkruajnë se si dhe me kë po ndërtojnë miqësi jashtë kishës. Si rrjedhojë, gjatë 10 viteve të fundit, anëtarësia e kishës është shtuar pesëfish.

Disa persona mund të pretendojnë se kanë thirrje për të shërbyer brenda kishës dhe jo të ungjillizojnë ata të cilët nuk e kanë njohur ende Zotin. Unë nuk kam asnjë dyshim që disa njerëz kanë thirrje të punojnë kryesisht me besimtarë, si për shembull, të japin mësim në universitete ose shkolla të krishtera, ose të menaxhojnë një agjenci të krishterë dhembshurie, ose të drejtojnë një denominacion të krishterë. Këto lloj agjencish luajnë një rol të rëndësishëm në Mbretëri dhe kanë vlerë shumë të madhe për një sërë arsyes. Dhe shpeshherë, njerëzit në këto profesione do të kalojnë më shumë kohë me të krishterë sesa me jo të krishterë. Megjithatë, edhe ata duhet të kuptojnë se "puna e tyre e krishterë" nuk mund ta zërë kurrë vendin e misionit të Perëndisë. Ajo mund të mbështesë dhe t'u vijë në ndihmë të tjerëve që fokusohen tek ungjillizimi, por nuk do t'i çlirojë kurrë ata nga thirrja bazë e Mbretërisë për të ndarë besimin e tyre në Krishtin me ata të cilët nuk e kanë përjetuar ende realitetin dhe fuqinë e sundimit të Tij. Ata që punojnë me kohë të plotë në biznese dhe agjenci të krishtera duhet të kujdesen më tepër për të ruajtur mundësinë për të takuar, për t'u miqësuar dhe për të ndikuar njerëzit që kanë nevojë për një përvojë shpëtuese me Zotin.



PASIVITETI NË RRJETËZIM

E kemi të lehtë që të marrim një qëndrim pasiv për ndërtimin e rrjeteve të kontaktit brenda bashkësisë së ngrohtë të një denominacioni. Udhëheqësit tanë të zgjedhur mbartin përgjegjësinë për ta mbajtur të bashkuar Bashkësinë. Ata planifikojnë takime vendore dhe rajonale. Ata menaxhojnë planet e pensionit dhe sigurimet shëndetësore. Ata i koordinojnë përpjekjet misionare dhe promovojnë shkolla të sponsorizuara nga një denominacion i caktuar, si dhe kryejnë detyra të tjera të denominacionit.

Shpeshherë misionarët në denominacione rrjetëzojnë në mënyrë të shkëlqyer, veçanërisht në ato grupe që besojnë në “misionin e besimit”. Duke ndërtuar një grup me rreth 100 ose më shumë kisha për të mbështetur punën e tyre, ata janë të kujdesshëm që të qëndrojnë në kontakt me atë litar shpëtimi financiar pavarësisht se në cilin vend të largët shërbejnë. Por, shpesh, pastorët e denominacionit kanë luksin që këto rrjetëzime t’ua sjellin të gatshme. Dhe duket se nuk kanë ndonjë nevojë për të qenë tepër të qëllimshëm rreth rrjetëzimit. Të qenit pjesë e një denominacioni sjell përfitime të mëdha, por kjo nuk duhet të na çojë drejt pasivitetit në rrjetëzim.

Dikush mund të mendojë se thelbi i punës së pastorit është rrjetëzimi. Unë mendoj që një lloj i caktuar i rrjetëzimit është me të vërtetë thelbi i punës efikase të pastorit. Por shumë udhëheqës kishash nuk duken aq energjikë sa duhet në rrjetëzimin e tyre. Madhësia mesatare e kishave në SH.B.A. është rreth 75 anëtarë.¹ Nga ky fakt, duket që shumica e pastorëve arrijnë të kryejnë shërbesën e tyre në një rreth social goxha të vogël – diku tek 500 deri në 1000 njerëz.

Një rreth kaq i vogël mund të rezultojë në një komunitet të ngrohtë besimtarësh, por këto komunitete shpesh mund të bëhen shumë të përqendruara së brendshmi. Pa një proces energjik të rrjetëzimit të vetëdijshëm dhe të vazhdueshëm, rrethi nuk rritet. Dhe një kishë e fjetur e ka të vështirë që të shpjegojë se çfarë do të thotë të ndjekësh Jezusin dhe t’i bindesh Porosisë së Madhe. Nuk po dënojmë askënd këtu, sepse mund të ekzistojnë arsye se pse një kishë e caktuar nuk mund të rritet në vendndodhjen e saj specifike. Por kishat e tilla kanë për ta ndjerë gjithmonë se po mungon diçka e rëndësishme. Nëse një kishë me të vërtetë nuk mund të rritet për shkak të vendndodhjes së saj, atëherë ajo ka një përgjegjësi të rëndë shtesë për të ndihmuar kishat në vende të tjera që të rriten. Kjo kërkon prej tyre që të përfshihen thellë në Porosinë e Madhe duke dërguar, duke dhënë dhe duke u lutur.

MARRËDHËNIE TË ZHVILLUARA PLOTËSISHT

Disa njerëz supozojnë se ne mund të jetojmë jetë të ndara në kabina, ku mund ta lëmë Jezusin në shtëpi ose në kishë. Shumë të krishterë nuk e mirëpresin

Jezusin në vendin e tyre të punës. Si rrjedhojë, flasim për Jezusin me miqtë tanë që tashmë i besojnë Atij, dhe nuk flasim për Jezusin me ata që nuk besojnë ende tek Ai. Por rrjetëzimi i Mbretërisë nuk do të qarkullojë në atë qark të shkurtër. Zhvillimi i miqësive të plota, të mbushura me aktivitete të përbashkëta jashtë aktiviteteve fetare, pothuajse gjithmonë prodhon frytet më të pjekura. Disa nga këto aktivitete mund të jenë: të ndihmoni njerëzit që transferohen në shtëpinë e re, të luani ping-pong, të shkoni në ngjarje sportive, të qëndisni, të luani në bandën e qytetit, ose të bëheni aktiv në një organizatë qytetare. Mundësitë janë po aq të shumëllojshme sa edhe interesat njerëzore.

Ndërkohë që marrëdhëniet e vërteta rriten, fillon të dalë në pah realiteti i Krishtit në jetët tona. Ndonjëherë, marrëdhëniet e thella na lejojnë t’i ndajmë rrjetet tona të Mbretërisë me njerëzit në mënyra që u leverdis profesionalisht ose personalisht në aspekte tërësisht jofrymërore. Ndërsa i mbështesim me lutjet tona dhe i angazhojmë me rrjetën e Perëndisë, eventualisht do t’i prekim gjithashtu edhe nga ana frymërore. Duhet të lutemi me besnikëri për kolegët tanë, pavarësisht se çfarë bëjmë tjetër për t’i sjellë ata tek Krishti.

RRJETËZIMI I JEZUSIT

Jezusi e zgjeroi rrjetën e Mbretërisë kudo ku shkoi, duke thirrur njerëz të tillë si Levi dhe Zakeu, të cilët ishin tagrambledhës, në pendim dhe falje dhe në një jetë të ndryshuar që i vuri aftësitë e tyre në punë në mënyra të reja. Ai pati takime me mëkatarë dhe me fetarë, me njerëz të fuqishëm dhe me njerëz të shtypur, me të sëmurë dhe të shëndetshëm. Ai mori mbështetje kyçe nga një djalë i vogël me disa bukë dhe disa peshq, të cilat i shumoi për të ushqyer një grup të madh njerëzish. Ai hëngri një vakt me pothuajse të gjithë njerëzit që takoi. Në të gjitha këto takime ose kontakte, Ai dha mësim një klasë masteri në marrëdhëniet njerëzore. Duke parë zgjerimin spektakolar të Krishtërit pasi Jezusi filloi të shpallte rrjetën e Mbretërisë, një ‘rrjetëzues’ i urtë do ta bënte studimin e mënyrës se si u përball Jezusi me njerëzit, librin e tij më të mirë shkollor rreth rrjetëzimit.



JOSEPH L. CASTLEBERRY, Ed.D.,
është presidenti i universitetit
Northwest në Kirkland, Uashington.

Ky artikull është një ekstrakt nga libri “*Rrjeta e Mbretërisë: të Mësojmë që të Krijojmë Lidhjet Tona Ashtu siç Bëri Jezusi*” (Kisha Ime e Shëndetshme, 2013)

Shënime

1. Instituti Hartford për Hulumtime Fetare.
http://hirr.hartsem.edu/research/fastfacts/fast_facts.html#sizecong. (marrë më 15 gusht 2013).



TË MBAJMË BASHKË

Dhembshurinë DHE *Ungjillizimin*

Nga: JERRY IRELAND

Ndërkohë që e vetmja mënyrë për t'i drejtuar njerëzit te Jezusi është ndarja e mesazhit të Ungjillit, ka pak gjasa që mesazhi ynë të merret në konsideratë nëse jetët tona janë në kontradiktë me atë që shpallim. Ja se si t'i mbajmë bashkë ungjillizimin dhe dhembshurinë.

Q

ë njerëzit të vijnë në njohjen shpëtuese të Jezusit, ne duhet të predikojmë Ungjillin, lajmin e mirë të Jezus Krishtit. Perëndia na ka folur me fjalë dhe na ka dhënë një mesazh verbal. Është e domosdoshme që këto fjalë shprese t'i ndajmë me botën (Kolosianëve 1:5).

Megjithatë, është po aq shumë e rëndësishme që të sillemi “në një mënyrë të denjë në ungjillin e Krishtit” (Fili-pianëve 1:27). Të jesh një ndjekës i Krishtit nuk ka të bëjë vetëm me një miratim logjik të listës me gjërat që duhen bërë dhe s’duhen bërë. Por, do të thotë që e gjithë jeta jonë është e riorientuar në mënyrë radikale për shkak se jemi kthyer nga gënjeshtra tek e vërteta, nga errësira në dritë. Në fakt, do të thotë që vetë ne duhet të jemi drita (Mateu 5:13). Pali na kujton tek 1 Thesalonikasve 1:3 se puna jonë si ndjekës të Krishtit është, në fund të fundit, e shtyrë nga dashuria.

Midis viteve 1996 dhe 2006, numri i jo të krishterëve që e shihnin krishtërimin me një sy të mirë ra me më shumë se 20 për qind, sipas librit “unChristian” (“I çkrishterë”) nga Dejvid Kinamen (David Kinnaman).¹ Kjo përfaqëson një largim radikal nga Kisha e hershme, një kishë që merrte lavdërime edhe nga kritikët e saj për shkak të dashurisë së saj për ata që ishin jashtë kishës, veçanërisht për të varfrit dhe të sëmurët.

Në librin e tij “Ungjillizimi në Kishën e Hershme” (*Evangelism in the Early Church*) Majkëll Grin (Michael Green) vëren se: “Kisha kishte cilësi të pakrahasueshme në botën e lashtë. Në asnjë vend tjetër nuk do të gjeje skllëvër dhe skllavopronarë, hebrenj dhe johebrej, të pasur dhe të varfër, duke u angazhuar në bashkësi rreth tryezës dhe duke treguar dashuri të vërtetë për njëri-tjetrin. Kjo dashuri rrodhi nga brenda-jashtë kishës dhe në kohë fatkeqësish apo katastrofash të krishterët shkëlqyen përmes shërbesës së tyre ndaj komuniteteve në të cilat jetuan.”

Grin shton se: “Në ditët e sotme është e vështirë që të dallohet stili i jetesës së të krishterëve (nga ai i jo të krishterëve) ... Nevoja jonë për plotësinë ... mund të plotësohet dhe mbështetet vetëm nga dashuria e pakushtëzuar. Kështu dashuron edhe Perëndia, dhe të krishterët e hershëm duket se kanë marrë aq shumë ngrohtësi nga dashuria e Tij sa që ajo i ka mbajtur bashkë dhe madje ka rrjedhur në mënyrë të natyrshme prej tyre”.²

Sigurisht, ne duhet ta bashkojmë dhembshurinë me komunikimin. Disa pretendojnë se thirrja e krishterë nuk ka të bëjë fare me atë se çfarë themi, por vetëm me nevojën tonë për t’u përfshirë në vepra me dashuri. Shkrimtari Greg Geret (Garrett) shkruan: “Thirrja jonë si ndjekës [të Jezusit] është që të përpiqemi të ecim në botë me dhembshurinë e

Krishtit, për të manifestuar dashurinë e Perëndisë me vepra, dhe jo me fjalë”.³

Ndërkohë që Geret përfaqëson një pozicion ekstrem, ai arrin të nxjerrë në pah ndarjen brenda kishës rreth pyetjes se si ta kuptojmë më mirë detyrën tonë në botë. Ne duhet t’u kthehemi mësimëve të Shkrimit për të kuptuar dhembshurinë nga një perspektivë biblike. Këto theme mund të na ruajnë nga humbja e fokusit të thirrjes sonë për të ungjillizuar ndërkohë që reagojmë me dashurinë e Krishtit ndaj nevojave përreth nesh.

DHEMBSHURIA DHE MBRETËRIA E PERËNDISË

Bibla i thërret njerëzit e Perëndisë që të tregojnë dhembshurinë si një reflektim të natyrës dhe mbretërisë së Perëndisë. Dhjata e Vjetër e karakterizon mbretërimin e Perëndisë thellësisht në aspektin e drejtësisë dhe të barazisë, duke shpallur se këto dy cilësi formojnë themelin e fronit të Tij (Psalmet 89:14; 97:1, 2). Duke qenë kështu, Perëndia pret që populli i Tij t’i mishërojë këto cilësi. Në Dhjatën e Vjetër, drejtësia dhe barazia lidhen veçanërisht me karakterin hyjnor të Perëndisë dhe me pritshmërinë e një populli të shenjtë i cili është krijuar në imazhin e Tij (Zanafilla 1:26,27; 1 e Mbretërve 10:9). Perëndia ynë i shenjtë e urren

Kur kisha reagon në këtë kohë ndaj atyre që kanë uri dhe etje dhe mungesë të nevojave bazë të jetës, kur ngushëllojmë ata që vajtojnë, atëherë bëhemi një komunitet që mishëron shpresën që shpallim.

shtypjen dhe pabarazinë, viktimat e të cilave më së shpeshti janë të varfrit dhe nevojtarët.

Në Dhjatën e Re, vepra e Jezusit në kryq e bën shpëtimin të disponueshëm për të gjithë njerëzit (Luka 18:25; Gjoni 3:5). Ndjekësit e Krishtit transformohen për t'u bërë si Jezusi. Kjo përfshin marrjen pjesë në dhembshurinë e Tij për botën. Të jesh i shpëtuar do të thotë të jesh me mendje nga Mbretëria dhe të mishërosh atë për të cilën interesohet Mbreti. Ata që vijnë në besim te Krishti përjetojnë një riorientim radikal të jetëve të tyre, duke përfshirë një interesim të ri për të varfrit.

Këtë e shohim të ndodhë tek Shkrimi në një sërë skenarësh. Për shembull, Zakeu vjen në besim te Jezusi dhe u jep gjysmën e pasurisë së tij të varfërve (Luka 19:8–10). Nga ana tjetër, ata që nuk arrijnë ta bëjnë Jezusin Zotin e tyre dhe të mishërojnë ato për të cilat Ai interesohet largohen të trishtuar, duke treguar se dashuria e tyre për pasuri paraqet një pengesë për të qenë pjesë e Mbretërisë (Luka 18:23). Kështu që, qëndrimet dhe prioritetet tona tregojnë ndikimin e Krishtit në jetët tona.

Një kishë e dhimbsur reflekton karakteristikat e Atij që ne rrëfejmë si Mbretin tonë. Qëllimi ynë, kur tregojmë dhembshuri, nuk është të sjellim një shoqëri utopike - madje as mbretërinë e Perëndisë. Vetëm Perëndia e sjell mbretërinë e Tij. Por duke treguar dhembshuri, ne japim prova se Mbreti i Drejtësisë jeton në mesin tonë dhe brenda nesh. Sa e çuditshme do të ishte që të shpallim Perëndinë si Zot dhe mbret, një Perëndi i cili shfaq shqetësim të madh për të varfrit (1 e Samuelit 2:8; Psalmi 113:7), dhe të mos i vëmë prioritetet e Tij gjithashtu në praktikë. Kur ne i shpërfillim shqetësimet e Mbretit, atëherë nuk jemi nënshetësit e Tij besnikë.

NJË DËSHMITAR I BESUESHËM

Ungjilli vetë, pa ndihmën e askujt, është i besueshëm. Nuk është e nevojshme që ne ta bëjmë të besueshëm. Është i besueshëm dhe autoritar sepse e ka origjinën e tij te Perëndia (2 e Pjetrit 1:21). Në kuptimin e plotë të fjalës, ai është i frymëzuar nga Perëndia (2 Timoteut 3:16). E megjithatë, sjellja e komunitetit të krishterë është shumë e dobishme për të përcaktuar nëse ungjilli i besueshëm do të dëgjohet mjaftueshëm. Nëse jetët tona nuk përputhen me atë që themi, mesazhi ynë ka shumë gjasa që të mos nxisë ndonjë mendim serioz.

Jezusi thotë se mandati i kishës është të dëshmojë për Të (Veprat 1:8). Shpallja është padyshim një pjesë kyçe e kësaj dëshmie. Megjithatë, fjala greke e përkthyer si “dëshmitarë” (μάρτυρες) te Veprat 1:8 është e njëjta fjalë nga e cila marrim fjalën shqip martir (dëshmor). Atëherë të jesh dëshmitar i jetës dhe shërbesës së Krishtit përfshin një përkushtim të plotë si të fjalëve, ashtu edhe të veprave tona – dhe madje të vetë jetëve tona.

Fragmente të shumta në Shkrimin e Shenjtë e lidhin besimin te Jezusi me pritshmërinë e veprave që reflektohen nga ky besim. Jezusi i thotë Nikodemit: “Por kush bën të vërtetën vjen te drita, që veprat e tij të zbulohen, sepse u bënë në Perëndinë” (Gjoni 3:21). Po në të njëjtën mënyrë, Pali thotë se ata që besojnë në Perëndi rrjedhimisht “kujdesen për të kryer vepra të mira” (Titit 3:8). Shkrimi nuk lejon veçimin e thirrjes tonë për të predikuar ungjillin nga thirrja për ta jetuar atë. Mënyra se si jetojmë në botë flet shumë rreth masës se sa i kemi dëgjuar dhe kuptuar në të vërtetë fjalët e Jezusit.

Shërbesa “Sfida e Adoleshentëve” (program për adoleshentët me probleme varësie) më ndihmoi që të vija në njohjen shpëtuese të Krishtit pas 10 vitesh varësie nga droga. Unë hyra në këtë program si një agnostik i cili kishte dyshime serioze rreth ekzistencës së një Perëndie të plotfuqishëm dhe që i do të gjithë njerëzit. Megjithatë dashuria dhe mirësia e një çifti të moshuarish luajtën një rol kyç në ardhjen time në besim. Çdo fundjavë, Poli dhe Norma hapnin derën e shtëpisë së tyre për të gjithë programin e meshkujve të kësaj shërbese në qytetin e Bufalos në Nju Jork. Ata mikpritën rregullisht në shtëpinë e tyre nga 20 deri në 30 persona të varur nga droga dhe



Qëllimi ynë, kur tregojmë dhembshuri nuk është të sjellim një shoqëri utopike - madje as mbretërinë e Perëndisë. Por duke treguar dhembshuri, ne japim prova se Mbreti i Drejtësisë jeton në mesin tonë dhe brenda nesh.

alkooli për të ngrënë një vakt dhe për të kaluar kohë me ta. Dashuria dhe dhembshuria e tyre mishëruan predikimet e përditshme që dëgjonim, duke na treguar se mesazhi që ata shpallnin ishte vërtet transformues.

SHPRESË E MISHËRUAR

Një tjetër mënyrë se si dhembshuria jonë i shërben misionit të kishës është përmes mishërimit të shpresës. Sipas Galatasve 6:10, ne duhet t'i bëjmë mirë të gjithë njerëzve. Ndërkohë që të krishterët i shërbejnë njëri-tjetrit, po ashtu edhe atyre jashtë kishës, përmes veprave të dashurisë dhe mirësisë, përmes shërbesës me të varfrit dhe nevojtarët dhe përmes interesimit për të sëmurët, ne tregojmë cilësitë e pakrahasueshme që na presin kur Jezusi të rikthehet dhe të sjellë ringjalljen përfundimtare.

Sipas autorit Xhulian Hart (Julian N. Hartt), kisha "duhet të shpalosë mbretërinë e përjetshme të Perëndisë përmes normave dhe shembujve".⁴ Kështu që, kisha duhet të jetë një komunitet në miniaturë i të ardhmes në të cilën Perëndia po na udhëheq, një e ardhme shërimi dhe plotësie në çdo fushë të jetës.

Te libri i Zanafillës, lexojmë për të ardhmen që e pret popullin e Perëndisë. "Ata nuk do të kenë më uri, as nuk do të kenë etje, as nuk do t'i godasë më dielli, as kurrfarë vape, sepse Qengji, që është në mes të

fronit, do t'i kullosë dhe do t'i çojë te burimet e gjalla të ujërave; dhe Perëndia do të thajë çdo lot nga sytë e tyre"(Zbulesa 7:16, 17).⁵

Kur kisha reagon në këtë kohë ndaj atyre që kanë uri dhe etje dhe mungesë të nevojave bazë të jetës, kur ngushëllojmë ata që vajtojnë, atëherë bëhemi një komunitet që mishëron shpresën që shpallim.

Çdokush që udhëton shpesh ka përjetuar, me shumë mundësi, në një pikë të caktuar të udhëtimit, një kalim në klasin e parë. Kjo më ndodhi mua kohët e fundit në fluturimin e dytë të një udhëtimi me tri ndalesa për në Afrikë. Ndërsa e akomodova veten në sediljen/krevatin luksoz e të rehatshëm, i thashë vetes: "Kjo është një gjë shumë e keqe!".

E dija që pasi të kisha shijuar të ashtuquajturën jetë të mirë, do ta kisha të vështirë uljen në klasin e dytë të avionit. Dhe me të vërtetë, në fluturimin e fundit të udhëtimit, ajo sedilje që më parë kishte qenë e pranueshme për bukuri për mua, tani dukej e ngushtë dhe aspak e kënaqshme.

Kjo është pikërisht ideja pas shpresës së mishëruar. Ndërkohë që kisha, e fuqizuar nga Fryma e Shenjtë, mishëron cilësitë e të ardhmes tonë qiellore, ne do të flasim shumë për një shije të një jete tërësisht në klasin e parë – jetën me bollëk që premton Jezusi (Gjoni 10:10). Ndërsa jobesimtarët i përjetojnë këto cilësi dinamike, bëhet akoma më e vështirë që t'i kthehesh një jete të ndarë nga Krishti.

DHEMBSHURIA DHE UNGJILLIZIMI

Shumica e gabimeve në lidhje me dhembshurinë rrjedh nga një i kuptuar i gabuar i mbretërisë së Perëndisë sipas Biblës. Ata të cilët e kuptojnë mbretërinë në terma tërësisht tokësorë shpesh



*Nëse dhembshuria nuk është
pjesë unike e jetës sonë në
Krishtin, veprat tona nuk do
të jenë të singerta.*

fokusohen tek mësimet morale dhe etike të Shkrimit, ndërkohë që lënë pas dore aspekte të tilla si mëkati individual dhe gjykimi. Disa të tjerë, të interesuar vetëm për aspektin e të ardhmes së mbretërisë së Perëndisë, i vënë theksin shpëtimit të shpirtave, ndërkohë që anashkalojnë nevojat e tjera njerëzore.

Shkrimi i hedh poshtë të dyja këto pikëpamje të njëanshme të mbretërisë së Perëndisë. Jezusi na mësoi se mbretëria është një realitet i të tashmes dhe të ardhmes (Mateu 7:21; Luka 11:20). Prandaj, çelësi i parë për të parandaluar eklipsimin e ungjillizimit nga dhembshuria është të mbajmë një balancë biblike të mbretërisë së Perëndisë në të tashmen dhe në të ardhmen - atë që tashmë është dhe atë që akoma nuk ka ardhur. Duke qëndruar të balancuar, mund të shmangim mbitheksimin e mandatit shoqëror dhe të dhembshur të ungjillit. Po në të njëjtën mënyrë, mund të shmangim një pikëpamje krejtësisht të së ardhmes rreth Mbretërisë, të cilës i mungon zbulesa bashkëkohore dhe që e lë kishën të duket e ftohtë dhe e pandjeshme për sa i përket vuajtjes njerëzore në të tashmen.

Gjykimi është një tipar kyç i dimensionit të së ardhmes së Mbretërisë së Perëndisë. Kur e minimizojmë aspektin e të ardhmes së Mbretërisë, gjykimi i Perëndisë që do të vijë është shpesh fatkeqësia e parë që vjen nga ky mosbalancim. Pa gjykim, nuk mund të ketë drejtësi. Perëndia është i drejtë sepse ai është gjykatësi i drejtë. Në kontekstin e ungjillizimit tonë të dhembshur, duhet t'ia atribuojmë padrejtësinë mëkatit. Nëse nuk mblidhemi për të folur për mëkatin dhe gjykimin, përpekjet tona të dhembshurisë nuk mund të quhen vërtet të krishtera.

PËRFUNDIMI

Si një student i programit "Sfidë për Adoleshentët", unë i vëzhgova nga afër Polin dhe Normën për të parë nëse veprat e tyre ishin në të njëjtën linjë me fjalët e tyre. Mbaj mend që pyesja veten: "Pse e bëjnë ata këtë gjë? Çfarë përfitojnë këta nga e gjitha kjo?".

Mendoja kështu sepse vija nga një jetë në të cilën marrëdhëniet ishin kryesisht utilitare. Njerëzit kishin prirjen që ta përdornin njëri-tjetrin. Por ndërsa shihja Polin dhe Normën, fillova të kuptoj se motivimi i tyre i vetëm ishte dashuria. Ata bënë atë që bënë për shkak se kishin një dashuri unike për njerëzit të cilët shoqëria i kishte përjashtuar. Kuptova që ky çift i krishterë kishte diçka të panjohur për mua: një dashuri radikale për të tjerët që rridhte nga dashuria e tyre për Perëndinë. Veprat e tyre të dashurisë përfshinin edhe ndarjen e Ungjillit, por edhe të pasurisë së tyre. Dhe për shkak se veprat e tyre ishin në të njëjtën linjë me atë që po na mësohej neve, unë fillova ta marr në konsideratë seriozisht të vërtetën dhe rëndësinë e Biblës për jetën time.

Ne nuk duhet ta shohim dhembshurinë si një platformë apo një pikë hyrëse për të fituar besimin e të tjerëve. Nëse dhembshuria nuk është pjesë unike e jetës sonë në Krishtin, veprat tona nuk do të jenë të sinqerta. E gjejmë veten në pozitën e sikletshme dhe jobiblike të shtirjes së dashurisë

Përgjërim për Ballkanin

O Zot,

Sa i madh je Ti

Që e nxit shpirtin tim

Të lutet më fort.

Të përgjërohet

akoma më shumë,

Duke u lutur për kombe

Të pashkelura nga unë.

Fjala Ballkan

Kaq fort më tingëllon,

Duket se rënkon,

Ka nevojë të dëgjojë.

Dhe unë,

Para fronit Tënd ta sjell

Që të shpëtojë,

Të shpëtojë.

Nga: Arjana Spahija

(duke u sjellë kështu sa për sy e faqe) në vend që të predikojmë rreth dashurisë – një pozitë krejtësisht e huaj për jetën dhe shërbesën e Jezusit. Kur bëhet e dukshme se dashuria jonë ishte thjesht një mjet për të arritur një qëllim (dhe do të bëhet më e dukshme nëse është kështu), atëherë rrezikojmë ta lëmë personin më keq nga gjendja që ishte më parë. Më pas, në vend që thjesht të jenë të paditur ndaj Ungjillit, ata mund të bëhen armiqësor haptazi ndaj tij.

Ndërkohë që e vetmja mënyrë për t'i drejtuar njerëzit te Jezusi është ndarja e mesazhit të Ungjillit, ka pak gjasa që mesazhi ynë të merret në konsideratë nëse jetët tona janë në kontradiktë me atë që shpallim. Po kështu na udhëzon edhe apostulli Gjon: “Djema të rinj, të mos duam me fjalë, as me gjuhë, por me vepra dhe në të vërtetë” (1 e Gjonit 3:18).

E ndarë nga ungjillizimi, dhembshuria mund të ofrojë vetëm ngushëllim të përkohshëm. Por njerëzimi ka nevojë për më shumë sesa ngushëllim. Ka nevojë për shpëtim. Dhe ne e shpallim më së miri këtë shpëtim kur predikojmë lajmin e mirë dhe përfshihemi në vepra të mira.⁶

Shënime

1. David Kinnaman, *unChristian: What a New Generation Really Thinks About Christianity ... And Why It Matters* (Grand Rapids, Michigan: Baker Books, 2007).
2. Michael Green, *Evangelism in the Early Church*, (Grand Rapids, Michigan: Wm. B. Eerdmans Publishing, 2004), 20.



GRATË DHE UNGJILLIZIMI

Nuk mund t'i shpërfillim gratë. Duke filluar që nga kopshti i Edenit në librin e Zanafillës, Bibla i shfaq gratë si pjesëmarrëse kryesore në shpëtimin e premtuar të Perëndisë përmes Birit të Tij, dhe si objekte të skemave të Satanit për të shkatërruar qëllimet shpenguese të Perëndisë.

Planeti ynë është shtëpia ku jetojnë 3.5 miliardë gra dhe vajza.¹ Këto nuk janë thjesht statistika; por përfaqësojnë njerëzit tek të cilët Perëndia ka thirrur Kishën e Tij që t'iu sjellë lajmin e mirë të Jezus Krishtit. Ato përbëjnë 49.6 për qind të të gjithë popullsisë së botës.²

Në mesin e tyre, përafërsisht 35 për qind (1.2 miliardë) kanë përjetuar dhunë seksuale.³ Gjatë kohërave kur ka konflikte të armatosura apo katastrofa natyrore, bashkë me prishjen e infrastrukturës sociale, politike dhe familjare, që shoqëron këto kohë fatkeqësish, në veçanti gratë dhe vajzat janë të

3. Greg Garrett, "God Commands Compassion, Not Evangelism," http://day1.org/3351-greg_garrett_god_commands_compassion_not_evangelism. Marrë në 18 shkurt 2014.

4. Julian N. Hartt, *Toward a Theology of Evangelism* (New York: Abingdon Press, 1955), 67.

5. Në versionin shqip citimet janë marrë nga Bibla, Dhjata e Vjetër dhe Dhjata e Re © 2002 Botimi ABS, Shoqëria Biblike Shqiptare, SH.B.SH. Tiranë, Shqipëri.

6. Shih Ron Sider, *Good News and Good Works* (Grand Rapids, Michigan: Baker Books, 1999).



JERRY IRELAND është drejtori i degës së "AG Care" në Afrikë, e cila ndihmon shërbesën e dhembshurisë për të gjithë Afrikën Sub-sahariane për Misionin Botëror të Asambleve të Perëndisë në rajonin e Afrikës. Ai po vazhdon doktoraturën në teologji dhe apologjetikë në Universitetin "Liberty" në Linçbërg, Virxhinia (Liberty University in Lynchburg, Virginia).

cënueshme ndaj akteve të dhunës seksuale. Dhe shumë kultura e shohin femrën e dhunuar seksualisht si një mall të dëmtuar, duke e dënuar atë me një jetë skllavërie dhe shfrytëzimi seksual.

Shifra tronditëse në lidhje me popullsinë femërore në botë tregojnë për gra të plagosura, që shpesh kanë pësuar plagë të thella që vetëm Jezusi mund t'i shërojë. Dhe për shkak të normave sociale, kulturore dhe fetare, një shumicë e grave në botë që kanë nevojë për Jezusin mund të arrihen vetëm përmes grave të tjera të cilat janë të zjarrta për të ndarë Jezusin, që ato e duan aq shumë.

Fiona Bellsho (Fiona Bellshaw) është një nga këto zonja që, e mbushur me pasion, përpiqet që ta çojë Jezusin te gratë nga kombe të ndryshme të cilat jeta i ka sjellë në qytetin e saj të Madridit, në Spanjë. E lindur në Skoci, ajo shkoi në Spanjë me prindërit e saj misionarë ku edhe takoi e u martua me një drejtues të ri të krishterë, Huan Karlos Eskobar-in (Juan Carlos Escobar), i cili më vonë u bë drejtuesi i Asambleve të Perëndisë për Spanjën.

Ajo është gruaja e një pastori dhe vuri re gra që nuk ishin spanjolle të cilat detyroheshin të punonin si prostituta në rrugët e Madridit. Bellsho filloi të bëhej shoqe me këto gra, një e nga një sipas udhëheqjes së Perëndisë, duke u ofruar atyre miqësi, lutje dhe Jezusin. Ajo kërkoi dhe arriti të mernte leje për të vizituar gratë e trafikuar që mbaheshin në Qendrën e Strehimit për të Huaj. Atje ajo iu shërben grave që presin për t'u lënë sërish të lira në rrugë ose të dëbohen.

Vitin e kaluar, Bellsho dhe skuadra e saj e grave iu shërbyen grave që vinin nga 34 kombe (duke përfshirë edhe vende islamike), duke u lutur me to për ndihmë, shërim, çlirim frymëror dhe shpëtim. Disa gra e kanë marrë pagëzimin me ujë dhe janë në rrugëtimin e dishepullizimit, duke u bërë gra për Perëndinë. Bellsho është një ungjilltare e shekullit të 21-të.

Po kështu është edhe Koni Uizëll (Connie Weisel), pastorka e grave tek Asambleja e Parë e Perëndisë në Fort Majërs (Fort Myers), në Florida. Kur ajo ia përkushtoi jetën e saj krejtësisht Krishtit në moshën 38 vjeçare, Koni ishte një grua e suksesshme në biznes. Më pas, në vitin 1991, ajo filloi një klasë të hënave mbrëma në kishë e cila quhej "Ndihmë për gratë e lënduara", për t'iu ardhur në ndihmë grave si vetë ajo, të cilat kishin nevojë për një udhëtim shërimi me Jezusin. Gra të të gjitha moshave, niveleve shoqërore dhe prejardhjeve etnike të ndryshme erdhën nga përtej Floridës Jugperëndimore për një mbrëmje të mbushur me fjalë lavdërimi, lutje, studim Bible dhe shërbesë personale. Kjo klasë është takuar çdo të hënë mbrëma, përveç ditëve kombëtare të pushimit, për 23 vite me radhë. Përgjatë këtyre viteve, në

këto takime kanë marrë pjesë 46 mijë gra, nga të cilat 3450 kanë pranuar Krishtin për herë të parë ose e kanë përkushtuar jetën e tyre sërish te Krishti.

"Është thjesht e mahnitshme se sa mijëra vetë janë shpëtuar dhe kanë marrë jetën e plotë në një ambient kaq të thjeshtë," thotë Uizëll. "Kemi qenë besnike thjesht duke qenë atje, javë pas jave, me dashuri dhe ngushëllim për gratë, pavarësisht se cilat mund të jenë problemet".

Uizëll dhe skuadra e saj e udhëheqësisë nuk presin që gratë e lënduara të vijnë tek ato, por i kërkojnë këto gra dhe ndjekin udhëheqjen e Frymës gjatë gjithë javës, kudo që shkojnë: në restorante, dyqane ushqimore dhe vende të tjera biznesi, dhe i ftojnë gratë që të vijnë te klasa "Ndihmë për gratë e lënduara".

Uizëll dhe skuadra e saj besojnë në hedhjen e rrjetës për ata që kanë nevojë për Jezusin. Si rezultat i kësaj, "Ndihmë për gratë e lënduara" është një vend takimi për mrekullitë e shpëtimit dhe të shërimit.

Në qytetin e Bombeit, në Indi, punëtorët e programit për arritjen e grave, "Sfida e Adolehentëve të Bombeit", iu shërbejnë çdo vit mijëra grave dhe vajzave që gjenden nën kthetrat e prostitucionit. Disa nga këto gra të shpëtuar që më parë kanë qenë kujdestare të shtëpive publike apo femra të skllavëruara në prostitucion, e tani shërbejnë si ungjilltare, madje nga më të fuqishmet. Sot, ato e shpallin pa frikë Jezusin tek gratë e skllavëruara të cilat janë të dëshpëruara për të marrë çlirim. Si Maria Magdalena të shekullit të 21-të, ato shpërndajnë lajmin e mirë se Jezusi është i gjallë dhe është duke vepruar në botë (Gjoni 20:18). Pa marrë parasysh ferrin, ato largojnë demonë dhe çlirojnë gra.

Po, Satani i ka vënë gratë në shënjestër që në kopshtin e Edenit. Por Perëndia ka një plan shpengues më të madh për gratë dhe vajzat e kombeve. Dhe Ai vazhdon që t'i thërrasë bijat e Tij guximtare për të bërë punën më të madhe të ungjillizimit në mesin e tyre. Perëndia nuk i shpërfill gratë e botës. As ne nuk mund t'i shpërfillim.

BETH GRANT, *arsimtare, misionare, bashkëthemeluese e Projektit Shpëtim, dhe ndihmëse ekzekutive për Këshillin e Përgjithshëm të Asambleve të Perëndisë, duke përfaqësuar shërbesëtarët femra të certifikuar.*

Shënime

1. Census.gov
2. worldometers.info
3. who.int



Ndikim



përmes

Komunikimit

Nga: **MARCIA LEDNICKY**

A e keni nisur ndonjëherë mëngjesin tuaj me një lutje si kjo:

Zot i dashur, deri në këtë moment të ditës së sotme jam mirë. Nuk kam bërë thashetheme, nuk e kam humbur toruan e as nuk kam qenë e zemëruar. Nuk kam qenë lakmitare, as egoiste dhe as nuk kam qenë abuzuese. Megjithatë, pas disa minutash do të ngrihem nga krevati dhe do të më duhet më shumë ndihmë se kaq.

Dh **e kështu fillon dita jonë.** Në fakt komunikimi fillon që në momentin që shputat e këmbëve tona prekin dyshtemenë. Çfarë do të komunikojmë neve sot dhe si do ta bëjmë këtë gjë? Kushdo me të cilin do të kemi kontakt do të ndikohet në njëfarë mënyre. I gjithë ky artikull rreth komunikimit mund të fokusohet te bashkëshorti juaj dhe/ose te fëmijët

tuaj. Megjithatë, pasi të lexoni këtë artikull, mund të dilni nga dera kryesore dhe të shkoni të përshëndesni bashkësinë tuaj gjatë shërbesës së përjavshme të së dielës, të merrni pjesë në një ceremoni të veçantë për gratë në kishë, të bëni një punë publike apo edhe të bëni pazarin.

Kudo që shkojmë, do të jemi duke komunikuar me dikë, edhe me ata që mund të mos i njohim. Çfarë mesazhi do të komunikoj ndërsa lë strehën e shtëpisë sime?

Dhe pyetja tjetër është, si do të komunikoj? Ju mund të jeni duke pyetur veten se përse është kaq e rëndësishme kjo për ty si grua pastori. Asnjëherë mos harroni se çfarë mundësie e mrekullueshme ju është dhënë për të përfaqësuar Perëndinë. Një fjalë e ngrohtë apo një buzëqeshje e veçantë nga gruaja e pastorit mund të jetë pikërisht inkurajimi i duhur për dikë që ka nevojë atë ditë. Mund të mos dihet kurrë publikisht situata e vështirë që mund të ketë pasur një zonjë, përpara se të dalë nga shtëpia e saj për të ardhur te shtëpia e Perëndisë. Shpesh herë e komunikojmë dashurinë e Tij përmes veprave të thjeshta. Ndoshta arkëtari te dyqani i fruta-perimeve është duke u përballur me shumë mundime. Ose ndoshta personi që është përpara jush nuk është shumë i sjellshëm. Kjo është një mundësi fantastike që ju të tregoni dashurinë e Jezusit me anë të mënyrës se si e komunikoni identitetin tuaj si bijat e Tij.

Shumë është folur për të qenë vetvetja: “Duhet të jem vetja ime”. Dhe patjetër, unë dua të jem më e mira përmes Krishtit. Kjo më siguron që veprat dhe qëndrimet e mia do të flasin qartazi rreth dashurisë së Jezusit.

Shpesh, supozohet që personi që flet më shumë është komunikuesi më i mirë. Megjithatë, kjo nuk është doemos e vërtetë. A keni menduar ndonjëherë për këtë gjë? *Perëndia na ka krijuar me dy veshë dhe një gojë.* Mund të jetë më mirë që të dëgjojmë më shumë e të flasim më pak. *Komunikimi i vërtetë përfshin më shumë sesa thjesht të folurit.*

- ❖ Komunikimi përfshin gjithashtu të dëgjuarit. Komunikimi i mirë ka dy pjesë, edhe dërgimin e mesazhit, edhe marrjen e tij. *Komunikimi është një proces i ndarjes së informacionit me një person tjetër në mënyrë të tillë që tjetri e kupton se çfarë po thua.* Aftësia për të komunikuar është një cilësi e rëndësishme e udhëheqjes së mirë. Ajo ju ndihmon që të ndërtoni marrëdhënie të cilat zgjasin në kohë.
- ❖ *Komunikimi* nuk është thjesht ajo që themi, por mënyra se si e themi diçka. *Komunikimi është përshkruar si 10% fjalë, 40% intonacioni i zërit dhe 50% gjuha e trupit.* Prandaj është shumë e qenësishme që dashuria e Jezusit të mbushë zemrat tona. Ajo që është brenda do ta shfaqë gjithmonë veten jashtë. (Fjalët e Urta 4:23; Mateu 12:34)
- ❖ *Komunikimi* është verbal dhe jo-verbal. Komunikimi jo-verbal flet me zë shumë të lartë. Shpesh herë ne komunikojmë me *gjuhën tonë të trupit*. Thjesht mbledhja e supeve mund të tregojë një qëndrim që thotë “nuk më bëhet vonë”, ose “nuk është në dorën time”, ose “nuk e di”. Ndoshta një dorë përgëzimi në shpinë apo një rrahje shpatullash mund të sjellë gëzim tek një person tjetër. Po ashtu mund të jetë edhe dhënia e një dore të ngrohtë ose një buzëqeshje e çiltër. Ne komunikojmë kur qeshim ose kur nuk qeshim. Një përqafim ju thotë se jeni të veçantë, ose që i jemi futur bashkë kësaj valleje, ose që dikush ju do.
- ❖ Ne komunikojmë me *intonacionin e zërit tonë*. Intonacioni tregon gjendjen e zemrës. Fjalët mund të jenë të mira, por intonacioni mund të jetë i ashpër. Intonacioni mund të shprehë ndjenja mirësie, mirësjelljeje ose dashurie. Megjithatë, intonacioni mund të shprehë zili, inat, ose urrejtje.

Komunikimi i vërtetë përfshin më shumë se sa thjesht të folurit.

Sytë tanë dhe shprehja e fytyrës komunikojnë një mesazh.

- ❖ Tek Fjalët e Urta 6:16, 17, zbulojmë se një nga gjërat që Perëndia urren janë *“sytë krenarë”*. Kur vajza jonë ishte e vogël dhe nuk sillej mirë në kishë, ajo thoshte: “Babi më pa me ca sy të vrenjtur”. Me fjalë të tjera, babai i saj nuk kishte nevojë të thoshte asnjë fjalë. Ai thoshte shumë vetëm me sytë e tij.
- ❖ Mënyra si e shpenzojmë kohën tonë lëshon një deklaratë të fuqishme. Prania ose mungesa jonë vihet re shumë shpejt nga të tjerët.

Le të shohim disa gjëra që janë të dobishme për një komunikim të mirë. U ndesha me këto sugjerime që mund të jenë të dobishme (autori i panjohur).

1. Buzëqeshuni njerëzve. Kjo është kaq e thjeshtë dhe nuk të merr shumë mundim. Në fakt të duhen 72 muskuj për t'u ngrysur dhe 14 për të buzëqeshur. Fjalët e Urta 17:22: “Një zemër e gëzuar është një ilaç i mirë”. Dhe Fjalët e Urta 15:13: “Një zemër e gëzuar e bën të lumtur fytyrën”. Njerëzit kanë shumë dëshirë të kenë përreth persona që i bëjnë të ndjehen mirë për veten e tyre ose për rrethanat e tyre.

2. Flisni me njerëz. Asnjëherë nuk duhet të komunikohet një atmosferë superioriteti apo ftohtësie. A mund ta imagjinoni ndonjëherë Perëndinë tonë të mrekullueshëm që ofron këtë atmosferë superioriteti përreth Tij? Si përfaqësuesit e Tij në këtë botë të rënë e të humbur, dëshira jonë është të jemi si Ai në çdo kohë dhe në çdo mënyrë.

Është shumë e këndshme të marrësh një përshëndetje plot hare. Mbani kontakt të mirë me sytë. Është e lehtë për gruan e një pastori që të shohë vërdallë kur është duke folur me një person, duke e ditur që ka nevojë të flasë me një person tjetër. Kjo gjë më ka ndodhur personalisht në një rast. Ndërsa po shërbeja si gruaja e pastorit, një shoqe ndau me mua se ndihej shpesh sikur nuk doja t'ia dija për të. Kur isha duke folur me të, shumë herë shikoja vërdallë tek njerëzit e tjerë. I kërkoja ndjesë që kisha lënë atë përshtypje dhe i thashë se kjo nuk ishte aspak e vërtetë. Ajo më tha që tani e dinte. Në atë kohë unë jepja mësim lëndën e Kolegjit dhe të Karrierës në shkollën e së dielës. U kërkoja të rinjve në klasën time të më ndihmonin gjatë bisedave tona që ta fokusojnë të gjithë vëmendjen time tek ata. Dhe sigurisht ata ishin shumë të gatshëm për të ndihmuar. Një herë, kur po flisja me një djalë që vinte në klasën time, ai më tha: “Më shiko në sy, po flas me ty.” (Ishin një klasë fantastike!). Çdo person duhet të inkurajohet që të ndihet i veçantë, ashtu siç është për Jezusin.

3. Thirrini njerëzit me emër. Thuhet që gjëja që i pëlqen më tepër një njeriu që të dëgjojë është tingulli i emrit të vet. Për disa prej nesh, mbajtja mend e emrave të të tjerëve është goxha sfidë. Jam përpjekur ta përsëris emrin e një personi disa herë gjatë kohës që po flas me të dhe kjo më ka ndihmuar. Gjithashtu lidhja e emrit me diçka tjetër është e dobishme. Mbjaj mend që mamaja ime drejtonte një grup grash dhe në një rast prezantoi folësen. Mbiemri i folëses ishte Shauërs (Showers, që ka edhe kuptimin “reshje të lehta shiu”). Mamaja ime e lidhi emrin e saj me shiun e lehtë. Duke prezantuar folësen, ajo tha: “Jemi të nderuara të kemi në mesin tonë Znj. Spërkatje si folësen tonë të veçantë”.

4. Jini miqësore dhe ndihmuese. Përpikuni të veproni në mënyrë të tillë që njerëzit të ndihen më mirë pasi të kenë qenë në praninë tuaj. Mos e keqkuptoni përdorimin e fjalës “veprim”, sepse veprimet tona duhet të vijnë nga një zemër që është e mbushur në mënyrë unike me dashurinë e Perëndisë. Duhet të jetë një vërsim i dashurisë së Tij për njerëzit përreth nesh. Një person nuk mund të ketë miq, nëse vetë nuk është miqësor. Fjalët e Urta 18:24: “Njeriu që ka shumë miq duhet gjithashtu të tregohet mik”. Njerëzit duan ata njerëz të cilët i duan ata. Ndaloni për një moment dhe mendoni për njerëzit që doni. Ndoshta tashmë e dini që edhe ata ju duan gjithashtu.

5. Jini të dashura. Flisni dhe veproni sikur çdo gjë që bëni është kënaqësi. Kur ju jeni të dashur, po inkurajoni të tjerët që të jenë të dashur. Kjo është ngjitëse. Fjalët e Urta 16:24: “Fjalët e ëmbla janë si një huall mjalti, ëmbëlsi për shpirtin dhe ilaç për kockat”. Fjalët e Urta 15:1: “Përgjigja e ëmbël e fashit zemërimin, por fjala therëse e nxit zemërimin”. Kur jemi përballë një situatë të pakëndshme apo një individ të pakënaqur, ndjekja e paralajmërimeve nga këto vargje mund të na ndihmojë të komunikojmë në mënyrë të tillë që ta çtensionojë situatën e keqe.

6. Jini vërtet të interesuara rreth njerëzve. Jezusi ishte. Duke i dëgjuar me sinqeritet njerëzit, iu komunikojmë atyre idenë që ne kujdesemi për ta. Ajo që po ndodh në jetët e tyre është e rëndësishme. Nuk rrotullohet gjithçka vetëm rreth nesh. Dëgjoni me sy, ashtu siç dëgjoni edhe me veshë. Dëgjoni me të gjitha shqisat tuaja. Dëgjoni në mënyrë të sinqertë me zemrën tuaj.

Dale Carnegie ka thënë: “Mund të fitoni më shumë shoqe për dy muaj duke qenë me të vërtetë të interesuara rreth njerëzve të tjerë, sesa për dy vjet duke u përpjekur t'i bëni të tjerët të interesohen rreth jush”. Thuhet se: “Miqësia është si një llogari banke;

nuk mundesh vetëm të tërheqësh pa bërë asnjë derdhje”.

7. Jini zemërgjera me lavdërimet, të kujdesshme me kritikën. Është shpërblyes fakti kur e di që e ke bërë dikë të ndihet mirë. Njerëzit mund ta harrojnë atë që keni thënë apo keni bërë, por asnjëherë nuk do ta harrojnë si i keni bërë të ndihen kur kanë qenë me ju. Për çdo pohim kritik duhen katër komplimente për ta kompensuar atë vërejtje kritikuese. Kritika e vazhdueshme e vret frymën. Gjithashtu, ajo bën që personi t’ju shmanget juve dhe të sajojë justifikime. Kjo gjë ushqen një mungesë vetëvlerësimi dhe e bën tjetrin të ndihet i papranuar, i padashur dhe i pasigurt.

8. Merrini në konsideratë ndjenjat e të tjerëve. Një frymë e ndjeshme do të jetë gjithmonë e vlerësuar. Vargu tek Mateu 7:12 na këshillon që të bëjmë për të tjerët atë që do të donim që të tjerët ta bënin për ne. Shpeshherë është e pamundur që të dimë çdo rrethanë me të cilën mund të përballet një individ për momentin. Por nuk do të bëjmë asnjëherë gabim në rast se do t’iu tregojmë mirësi të tjerëve.

9. Jini vigjilente për një mundësi për t’iu shërbyer të tjerëve. Po, në fakt edhe duke u nisur nga pozita si gruaja e pastorit, ne kemi marrë këshillën që të jemi në shërbim të të tjerëve. Kolosianëve 3:23-24: *“Dhe çdo gjë që të bëni, ta bëni me dëshirë të mirë, si për Zotin dhe jo për njerëzit, duke ditur se nga Zoti do të merrni shpërblimin e trashëgimisë, sepse ju i shërbeni Krishtit, Zotit”*. Ngandonjëherë mund të duket se shumë nga përgjegjësitë tuaja janë dërmuese dhe tundoheni duke pyetur veten nëse ndonjërit i intereson apo i vë re të gjitha gjërat që ju po bëni. Ndoshta vazhdimisht po e thoni me vete: “kjo është për ty Zot, kjo është për ty”. Thjesht mbani mend se nuk mund të jepni më shumë se Perëndia, edhe në shërbesën tuaj. Dita e shpërblimit tuaj po vjen. Duke iu shërbyer të tjerëve, jeni duke komunikuar dashurinë tuaj të thellë dhe përkushtimin ndaj Zotit tonë,

ndaj shërbimit të Tij dhe ndaj të tjerëve.

10. Jini të duruara me të tjerët. Durimi është aftësia për të numëruar para se të shpërthesh. Duajt L. Mudi (Dwight L. Moody) i thoshte dikur audiencës së tij: *“Kam më shumë probleme me veten time sesa me çdo njeri tjetër që kam takuar në jetë”*. Pyetja është: *“Si mund të jemi të inatosur me të tjerët që nuk mund t’i bëjmë siç do të donim të ishin, kur ne nuk mund të bëjmë dot as veten tonë siç do të donim të ishim?”*.

Duke qenë se e kuptojmë që komunikimi ka të bëjë po aq me dëgjimin sa edhe me të folurën, qartazi lind pyetja: “Si t’i bëjmë të tjerët të flasin?” Mos flisni. Nuk mund të dëgjoni nëse jeni gjithë kohës duke dominuar bisedën. Nxiteni personin të fillojë të flasë. Filloni duke bërë pyetje të hapura. Mund t’i filloni fjalitë duke thënë diçka të tillë si p.sh. “atëherë ju ndiheni, ose ju mendoni ...”.

- ✓ Asnjëherë mos filloni të flisni e para.
- ✓ Pohoni me kokë dhe mbani kontakt me sy.
- ✓ Përsërisni diçka që kanë thënë ata.
- ✓ Mos e ndërprisni dhe mos e përfundoni fjalinë e tyre.
- ✓ Kushtojuni vëmendje të plotë.
- ✓ Mos mendoni se çfarë do të thoni më pas.
- ✓ Mos kini frikë nga një pushim gjatë një bisede.

Lexova një pohim ku thuhej: *“Arti i vërtetë i komunikimit nuk është vetëm të thuash gjënë e duhur në momentin e duhur, por gjithashtu, të lësh të pathënë gjënë e gabuar në momentin tundes”*.

Tek Jakobi 1:26 thuhet: *“Në qoftë se ndokush nga ju mendon se është fetar, edhe nuk i vë fre gjuhës së vet, sigurisht ai e mashtron zemrën e vet, feja e këtij është e kotë”*.

Gjërat që kemi diskutuar janë kaq shumë bazike dhe thelbësore, por ndonjëherë na duhet t’i kujtojmë vetes sonë se si vetëm disa vepra të thjeshta mund të jenë shumë domethënëse.

Kur bashkë me familjen u shpërngulëm, për shkak se im shoq u transferua nga shërbesa që kishte si pastor i një kishë të madhe në shërbesën si president i Kolegjit Biblik Qendror, për mua, ishte shumë e vështirë. Më pëlqente shumë të isha gruaja e pastorit. Muajt e parë kur filluam të shërbenim në kolegji, unë personalisht nuk kisha asnjë përgjegjësi “shërbese”. Dhe mendova: “O Zot, unë besoj se ti po vjen shpejt dhe kur të rikthehesh do të më gjesh duke bërë shumë pak për ty. Jeta ime nuk do të ketë asnjë vlerë për ty”. Perëndia ynë i

Kritika e vazhdueshme e vret frymën dhe bën që personi t’ju shmanget dhe të sajojë justifikime.

mrekullueshëm shikon thellë në zemrat tona dhe i di dëshirat tona më të singerta për t'i shërbyer Atij. Unë fillova të shkoja çdo ditë tek konvikti i kolegjit dhe lutesha: “Zot, nëse sot ka nevojë diku thjesht për një buzëqeshje ose ndoshta për një fjalë inkurajimi, bëj që të jem në vendin e duhur dhe në kohën e duhur”.


Dhe shumë herë kjo ndodhi. Shpesh isha e vetëdijshme që Perëndia më kishte vendosur në vendin e duhur në kohën e duhur. Ndonjëherë nuk e kisha vënë re atë takim hyjnor deri vonë, kur një person më thoshte se Perëndia më kishte lejuar mua që ta inkurajoja. Nuk ishte drejtimi i korit ose këndimi i një kënge të veçantë ose mësimdhënia në shkollën e së dielës sikurse i kisha bërë duke qenë gruaja e pastorit, por mësova rëndësinë e shërbesës ‘një me një’. Bekimet e pathëna të komunikimit të dashurisë së Jezusit përmes fjalëve, të një veshi dëgjues, një

buzëqeshjeje, një të rrahure shpatullave, një zëri të ngrohtë dhembshurie janë gjëra që ta pasurojnë jetën. Vetëm përjetësia do ta zbulojë me të vërtetë se çfarë është arritur përmes shpalosjes suaj të thjeshtë të kujdesit dhe të dashurisë së Krishtit.

Është një privilegj i veçantë që kemi për çdo ditë. Gra të dashura, jemi kaq të bekuara të kemi mundësinë të përfaqësojmë Krishtin. Dashuria e Perëndisë është kaq e vyer. Uroj që të keni një ditë shumë të mirë. Ndërsa ditës suaj i vjen fundi dhe nata afrohet për të marrë çlodhje, reflektoni mbi privilegjet e veçanta që keni pasur sot. Perëndia jua ka dhënë këtë ditë që të komunikoni dashurinë e Tij me njerëzit që ju rrethojnë. Unë lutem që në ndonjë mënyrë sado të vogël të kem “komunikuar” dashurinë time të thellë për Zotin tonë dhe punën e Tij dhe gëzimin që ne kemi si bija të Tij.



MARCIA LEDNICKÝ është një folëse e shpeshtë nëpër seminare dhe konferenca për femra. Ajo ka një aftësi unike për t'i lidhur sfidat e jetës së përditshme me të vërtetat e Shkrimit. Shërbesa e saj e të folurit në publik rritet me anë të talentit të saj vokal të jashtëzakonshëm përmes të cilit ajo komunikon dhe transmeton dashurinë e Krishtit.



Jona?! Po ti, mor i uruar..., nga na u mbyte tre ditë rresht...?!

Kishëmbjellja NË Bathore

Nga: MILJARD GOSTURANI

“Por duke parë turmat, patí dhembshuri për ta, sepse ishin të lodhur dhe të shpërndarë si delet që nuk kanë bari. Atëherë u tha dishepujve të vet: “E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak. Lutjuni, pra, Zotit të të korrave, që të dërgojë punëtorë në të korrat e tij”.

Mateu 9:36-38

Eshtë një realitet i hidhur, por i vërtetë; ashtu siç ishte në kohën e Jezusit, ashtu është edhe sot. Edhe në atë kohë, edhe sot, njerëzit kanë qenë si dele të shpërndara, të pambrojtura dhe të përhumbura për mungesë bariu. Dhe përveç kësaj, kjo turmë sa vjen dhe rritet. Në qoftë se në kohën e Krishtit ka qenë një e “korrë e madhe”, sot është akoma më e madhe. Duke parë këtë realitet, mbi të gjitha, duhet të përfshihemi në thirrjen e Zotit për punën e madhe që është predikimi i Ungjillit të Krishtit. Është kaq e rëndësishme përgjigjja jonë dhe bindja jonë e plotë ndaj Zotit të të korrave për t’u përfshirë në të korrat e Tij! Nëpërmjet këtij artikulli dua të flas shkurtimisht për përvojën tonë fillestare në mbjelljen e një kishe, edhe pse jemi akoma në fillim të projektit.

Rreth tre vite më parë, Zoti e vendosi në zemrën tonë Bathoren. Bathorja ndodhet në periferinë urbane veriore të Tiranës, 7 km nga sheshi Skënderbej.

Ka një sipërfaqe prej 454 hektarësh dhe një popullsi prej rreth 50.000 banorësh. Popullsia është kryesisht nga veriu dhe verilindja e Shqipërisë, si rezultat i migrimit të brendshëm të pakontrolluar, të shkaktuar nga varfëria. Pra, nevoja është e madhe në çdo drejtim, por mbi të gjitha në anën frymërore.

Duke e parë këtë nevojë, shpeshherë me pastorin tonë, Jose De Anchieta Dias, ne po mendonim dhe po luteshim se çfarë mund të bënim për të filluar diçka në këtë zonë në mënyrë që të ndajmë dashurinë e Zotit me ta. Por për hir të së vërtetës, nuk ishte e lehtë për ne, pasi jemi një kishë relativisht e re dhe jo shumë e rritur, që do të thotë e kufizuar, qoftë në njerëz (për sa i përket drejtuesve që do të shërbenin aty), qoftë në mundësi financiare. Por megjithatë, vendosëm që të ndërmarrim një hap besimi dhe të mos mbështetemi në mundësitë tona të prekshme. Dhe Zoti, si gjithmonë, nuk zhgënjën kurrë dhe kujdeset për punën e Tij. Ishte Ai që siguroi për të gjitha nevojat tona.

Më 6 qershor të vitit 2013, ne filluam. Zoti siguroi edhe një vend shumë të përshtatshëm para

Në 1 vjetorin e shërbesës.

Tashmë Zoti ka shtuar edhe të tjerë në këtë vepër, një përzierje kombësish por të bashkuar nga i njëjti qëllim, e njëjta zemër, një frymë e vetme, një trup i vetëm për të nderuar së bashku kreun, Krishtin.



derës së shkollës nëntëvjeçare, me hapësira të bollshme dhe me një çmim të favorshëm për ne. Zoti thirri shërbëtorët e Tij në atë vend. Si fillim, aty nisën të shërbejnë një çift nga Brazili të cilët kishin rreth një vit në kishën tonë, së bashku me dy drejtues nga kisha mëmë në Institut. Dhe jo vetëm kaq, por brenda një kohe të shkurtër, grupit iu bashkuan një misionare nga Rumania e një tjetër nga Finlanda, dhe secilit iu caktua përgjegjësia sipas dhuntisë që kishte. Pra, jemi një përzierje kombësish me larmi të ndryshme, por të cilët i bashkon i njëjti qëllim, e njëjta zemër, një frymë e vetme, një trup i vetëm për të nderuar së bashku kreun, që është Krishti.

Që në fillim u përpoqëm që të prezantoheshim si kishë, edhe pse kishim tundimin që të futeshim në komunitet si një qendër sociale. Sepse qëllimi ynë është që të kemi një kishë që në një të ardhme të jetë duke ecur vetë dhe që edhe ajo të shumëfishojë veten dhe të arrijë zonat përreth me Ungjillin. Por megjithatë, u përpoqëm që të kemi një ekuilibër edhe në këtë çështje, duke e parë edhe nevojën. Filluam me një takim lutjeje dhe në fakt e caktuam një ditë të veçantë lutjeje për kishën. Gjithashtu organizuam një takim vajzash, takim fëmijësh, takim grash, vizita në familje, dhe të dielën shërbesën kryesore. Por organizuam edhe kurse të ndryshme, si kurs të gjuhës angleze dhe të asaj italiane. Tani kemi edhe kurs rrobaqepësie në bashkëpunim me Radio 7 me gratë e veja dhe të divorcuara. Qëllimi është që të arrijmë mosha të ndryshme dhe shtresa të ndryshme sociale me ungjillin, por duke i ndihmuar gjithashtu edhe në kualifikime profesionale.

Në qershor ne mbushim dy vjet që jemi atje, por mund të themi që nuk kanë qenë dy vjet rehatie, pa vështirësi ose pa sakrificë. Fëmijët na kanë goditur me gurë. Adoleshentët prishnin takimin dhe të rinjtë bënin grindje me njëri-tjetrin. Por duke i parë ata ashtu siç i sheh Jezusi, duke i duruar dhe duke ndarë dashurinë me ta, fyerja u kthye në bekim dhe kërcënimet në falenderim. Sot pas dy vjetësh, mund të dëshmojmë së bashku që Zoti na ka drejtuar nga fitorja në fitore. Sot jemi të respektuar në sytë e shumicës prej tyre. Disa të rinj dhe adoleshentë kanë pranuar Krishtin, dhe kemi gjithsej rreth 15-20 persona që kanë pranuar Jezusin. Dhe për këtë, e lavdërojmë dhe e falënderojmë Perëndinë me anë të Jezus Krishtit, Zotit tonë.

Ne e dimë që kemi akoma shumë për të bërë, por dimë gjithashtu që Ai që e nisi këtë punë, edhe do ta përfundojë. Zoti siguron gjithmonë për punën e Tij. Ajo që kërkohet nga ne është bindja e plotë ndaj Tij dhe besimi i palëkundur në premtimet që Ai ka dhënë. Vëllezër dhe motra në Krishtin, bashkëpunëtorë të Mbretërisë së Perëndisë, le të guxojmë në shtrirjen e Mbretërisë! Le të zgjerojmë kufijtë e lokalitetit tonë! Zoti ka një popull të madh i cili duhet të arrihet, por Ai është duke pritur për ne. Le të shkojmë me këtë fuqi që kemi dhe t'i besojmë Zotit për rezultatet. *"Besnik është Ai që ju thërret, i cili edhe do ta bëjë"* (1 Thesalonikasve 5:24). Amen.



MILJARD GOSTURANI, është pastor i kishës Asambleja e Perëndisë Institut Kamëz.

